



BOTIM I VEÇANTË
UNIVERSITETI I PRISHTINËS

BOTUES:
UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Këshilli redaktues:
Akad. Jashar Rexhepagiq
Prof. dr. Hajrullah Koliqi
Mr. Shyqri Nimani, prof.ord.
Prof. as. Demë Hoti
Bajram Shatri, prof.
Destan Halimi, jurist i diplomuar

Redaktor përgjegjës
Destan Halimi
Sekretar i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës

SPECIAL EDITION
THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

PUBLISHER:
THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

Editorial Board:
Acad. Jashar Rexhepagiq
Prof. Dr. Hajrullah Koliqi
Shyqri Nimani, MA, Associate Profesor
Prof. Ass. Demë Hoti
Bajram Shatri
Destan Halimi

Responsible editor
Destan Halimi
Secretary General of the University of Prishtina

UNIVERSITETI
I PRISHTINËS
1970 – 2005

35

UNIVERSITY
OF PRISHTINA
1970 – 2005



Prishtinë - Prishtina

2005



NDËRTESA E REKTORATIT

RECTORATE BUILDING



NJËSITË AKADEMIKE
TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

PRISHTINA UNIVERSITY
ACADEMIC INSTITUTIONS

Përmbajtja

I. UNIVERSITETI I PRISHTINËS (1970-2005)	11
1. Institucionet e para të arsimit të lartë në Kosovë	12
2. Themelimi i Universitetit të Prishtinës dhe veprimtaria e tij 1970-1981	16
3. Universiteti i Prishtinës në vitet 1981-1991	21
4. Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1999	25
5. Universiteti i Prishtinës në dritën e reformës dhe veprimtaria e tij në periudhën 1999-2005	28
6. Disa konsekuenca të përgjithshme të Universitetit të Prishtinës	34
II. PËRFSHIRJA E GJENERATAVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS	41
III. DOKTORËT DHE ANËTARËT E NDERIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS	49
1. Doktorët e nderit	49
2. Titulli anëtar nderi i Universitetit të Prishtinës - postmortum	50
3. Titulli anëtar nderi i Universitetit të Prishtinës	51
IV. REKTORËT DHE PROREKTORËT (1970 – 2005)	55
1. Rektorët	55
2. Prorektorët prej 1970-2005	71
V. KRYETARËT E PLEQËSISË, TË KUVENDIT DHE TË SENATIT TË UNIVERSITETIT	77
VI. ANËTARËT E BORDIT - KËSHILLIT DREJTUES TË UNIVERSITETIT	81
VII. DEKANËT E FAKULTETEVE DHE DREJTORËT E SHKOLLAVE TË LARTA	85

Content

I. THE UNIVERSITY OF PRISHTINA 1970-2005	11
1. The first Higher Education Institutions in Kosova	12
2. The Foundation of the University of Prishtina and Its Activity 1970-1981	16
3. The University of Prishtina in the period 1981-1991	21
4. The Survival of the University of Prishtina 1991-1999	25
5. The University of Prishtina in the Light of Reforms and Its Activity in the Period 1999-2005	28
6. Some General Consequences to the University of Prishtina	34
II. INCLUSION OF GENERATIONS INTO THE UNIVERSITY OF PRISHTINA	41
III. DOCTORS AND MEMBERS OF HONOR OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA	49
1. Doctors of Honor	49
2. The title of an Honored Member of the University of Prishtina - post-mortem	50
3. The title of an Honored Member of the University of Prishtina	51
IV. RECTORS AND VICE-RECTORS 1970 – 2005	55
1. Rectors	55
2. Vice-Rectors 1970-2005	71
V. CHAIRPERSONS OF THE UNIVERSITY COUNCILS, ASSEMBLIES AND SENATES	77
VI. MEMBERS OF THE UNIVERSITY BOARD - STEERING BOARD	81
VII. FACULTIES DEANS AND HIGHER SCHOOLS DIRECTORS	85

VIII. SEKRETARËT E PËRGJITHSHËM
TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS99

IX. ANËTARËSIMI

DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR103

1. Anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare104

2. Bashkëpunimi ndërkombëtar
në bazë të marrëveshjeve bilaterale1053. Bashkëpunimi në projektet TEMPUS
dhe projekte tjera107

X. STATISTIKAT PËR STUDENTË

DHE PËR PERSONELIN AKADEMIK109

XI. FAKULTETET DHE SHKOLLAT E LARTA159

Fakulteti Filozofik159

Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore162

Fakulteti i Filologjisë165

Fakulteti Juridik168

Fakulteti Ekonomik171

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës174

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
dhe Kompjuterike177

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike180

Fakulteti i Mjekësisë183

Fakulteti i Arteve186

Fakulteti i Bujqësisë189

Fakulteti i Xehetarisë dhe i Metalurgjisë191

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit193

Fakulteti i Mësuesisë195

Fakulteti i Edukimit197

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë200

Shkolla e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda”
në Prizren203

Shkolla e Lartë e Biznesit në Pejë206

Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë208

Shkolla e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri”
në Gjakovë211Shkolla e Lartë Pedagogjike “Skënderbeu”
në Gjilan214

Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj217

XII. BIBLIOTEKA KOMBËTARE

DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS223

VIII. PRISHTINA UNIVERSITY

SECRETARIES GENERAL99

IX. INTERNATIONAL ADHERANCE

AND COOPERATION103

1. Adherence to the international network104

2. International cooperation
based on mutual agreements1053. Cooperation in TEMPUS projects
and other projects107

X. STUDENTS AND ACADEMIC STAFF

STATISTICS109

XI. FACULTIES AND HIGHER SCHOOLS159

Faculty of Philosophy159

Faculty of Mathematical-Natural sciences162

Philological Faculty165

Faculty of Law168

Faculty of Economics171

Faculty of Civil Engineering & Architecture174

Faculty of Electrical
& Computer Engineering177

Faculty of Mechanical Engineering180

Medical Faculty183

Faculty of Arts186

Faculty of Agriculture189

Faculty of Mining and Metallurgy191

Faculty of Physical Culture & Sports193

Faculty of Teachers Training195

Faculty of Education197

Higher Pedagogical School in Prishtina200

Higher Pedagogical School “Xhevdet Doda”
in Prizren203

Higher Business School in Peja206

Higher Engineering School in Mitrovica208

Higher Pedagogical School “Bajram Curri”
in Gjakova211Higher Pedagogical School “Skënderbeu”
in Gjilan214

Higher Engineering School in Ferizaj217

XII. NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY

OF KOSOVA223

I. UNIVERSITETI I PRISHTINËS 1970-2005

I. UNIVERSITY OF PRISHTINA 1970-2005

I. UNIVERSITETI I PRISHTINËS 1970 - 2005

*U*niversiteti i Prishtinës është institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor dhe kulturor në Kosovë. Më shumë se tridhjetë vjet ishte bartësi i vetëm i arsimit të lartë. Universiteti i Prishtinës është relativisht i ri – tridhjetepesëvjeçar, por rruga e zhvillimit të tij ishte dinamike, ndërsa veprimtaria arsimore, shkencore dhe artistike e tij ishte e pasur me rezultate të mëdha, të pamohueshme dhe me peshë historike. Fillimisht Universiteti kishte katër fakultete, ndërsa aktualisht ngërthen 14 fakultete dhe tri shkolla të larta, që janë:

1. Fakulteti Filozofik,
2. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,
3. Fakulteti i Filologjisë,
4. Fakulteti Juridik,
5. Fakulteti Ekonomik,
6. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës,
7. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike,
8. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike,
9. Fakulteti i Mjekësisë,
10. Fakulteti i Arteve,
11. Fakulteti i Bujqësisë,
12. Fakulteti i Xehetarisë dhe i Metalurgjisë,
13. Fakulteti i Kulturës Fizike dhe i Sportit,
14. Fakulteti i Edukimit,

I. UNIVERSITY OF PRISHTINA 1970 - 2005

*T*he University of Prishtina is the most important educational, scientific and cultural institution in Kosovo. For more than thirty years it was the sole carrier of higher education. The University of Prishtina is relatively new – thirty-five years old, but the path of its development was dynamic, and the educational, scientific and artistic activities were rich and with great results, with undeniable and historic weight. Initially, the University consisted of four faculties, and currently it includes 14 faculties and 3 higher schools, and they are:

1. The Faculty of Philosophy,
2. The Faculty of Mathematical-Natural Science,
3. The Philological Faculty,
4. The Faculty of Law,
5. The Faculty of Economics,
6. The Faculty of Civil Engineering and Architecture,
7. The Faculty of Electrical Engineering and Computer Engineering,
8. The Faculty of Mechanical Engineering,
9. The Medical Faculty,
10. The Faculty of Arts,
11. The Faculty of Agriculture,
12. The Faculty of Mining and Metallurgy,
13. The Faculty of Physical Culture and Sports,
14. The Faculty of Education,

15. Shkolla e Biznesit në Pejë,
16. Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë,
17. Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj.*

1. Institucionet e para të arsimit të lartë në Kosovë

Themelimi dhe veprimtaria e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë ndërlidhen me nevojat vendore për kuadro profilesh të ndryshme me arsim të lartë, sidomos nga radhët e popullsisë shqiptare.

Institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë ishte *Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë* (1958). Në fillim kishte këto grupe mësimore: Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe, Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë Serbokroate, Grupi i Biologjisë dhe i Kimisë, Grupi i BAT-it dhe i Fizikës, Grupi i Matematikës dhe i Fizikës. Në vitin e parë shkollor 1958/59 u regjistruan 93 studentë të rregullt dhe 55 me korrespondencë.

Në vitin shkollor 1961/62 u hap paralelja e SHLP të Prishtinës në Prizren, ku u regjistruan 100 studentë, 48 prej të cilëve ishin shqiptarë. Në vitin 1962 SHLP e Prizrenit bëhet e pavarur. SHLP e Prishtinës themeloi edhe Qendrën për studime me korrespondencë në Novi Pazar, me 50 studentë.

* Njësitë akademikenë numrin rendor 15, 16 dhe 17 me Vendim të Këshillit Drejtues të datës 05.09.2005 janë transformuar nga shkolla të larta në:

15. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë,
16. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara Teknike në Mitrovicë, dhe
17. Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj.

15. The Higher Business School in Peja,
16. The Higher Engineering School in Mitrovica,
17. The Higher Engineering School in Ferizaj.*

1. The First Higher Education Institutions in Kosova

The foundation and activity of our institutions of higher education in Kosova are intertwined with the local needs for various higher education staff profiles, particularly in the orders of Albanian population.

The first institution of higher education in Kosova was *the Higher Pedagogical School in Prishtina* (1958). In its beginning it had the following teaching groups: the Group of Albanian Language and Literature, the Group of Serbo-Croatian Language and Literature, the Group of Biology and Chemistry, the Group of Basic Education Engineering and Physics (BEEP), the Group of Mathematics and Physics. Ninety-three full-time and 55 part-time students were registered in the first year of studies in the academic year 1958/59.

In the academic year 1961/62, a group of the Prishtina Higher Pedagogical School (HPS) was opened in Prizren, where 100 students, 48 of

* The academic unit nder 15, 16, and 17, were transformed from higher schools into faculties by a decision of the Steering Board on 05 / 09 / 2005, as it follows:

15. The Faculty of Applied Sciences of Business in Peja,
16. The Faculty of Applied Sciences of Engineering in Mitrovica, and
17. The Faculty of Applied Sciences of Engineering in Ferizaj

Një vit pas SHLP të Prishtinës, në vitin 1959 u hap *Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë*. Gjatë dy viteve të para shkollore në këtë shkollë studionin 184 studentë të rregullt dhe 407 me korrespondencë.

Pasoi *Shkolla e Lartë Ekonomike Komerçiale në Pejë* (1960), në të cilën, në vitin e parë dhe të dytë, studimet i vijonin 362 studentë (186 të rregullt dhe 176 me korrespondencë).

Në të njëjtin vit (1960) u themelua edhe *Shkolla e Lartë Bujqësore në Prishtinë*. Në vitin shkollor 1961/62 u regjistruan 165 studentë të rregullt dhe 395 me korrespondencë.

Në tetor të vitit 1960 u hap edhe fakulteti i parë - *Fakulteti Filozofik në Prishtinë*, me gjashtë katedra: Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, e Gjuhës Serbokroate dhe e Letërsisë Jugosllave, e Matematikës, e Fizikës, e Kimisë, e Biologjisë. Pas një kohe të shkurtër, në vitin 1961/62 u themeluan edhe katedrat: Gjuhë dhe Letërsi Ruse dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Në vitin e parë akademik 1960/61 u regjistruan 97 studentë të rregullt (60 shqiptarë, 32 serbë dhe 5 të tjerë) dhe 141 me korrespondencë. Mësimin e mbanin 7 mësimdhënës (2 shqiptarë dhe 5 serbë) dhe 7 bashkëpunëtorë (2 shqiptarë e 5 serbë). Prej tyre 4 ishin doktorë shkencash dhe 1 magjistër.

Një vit më pas, më 1961, në Prishtinë u themelua edhe Fakulteti *Juridik-Ekonomik*, me dy drejtime: juridik dhe ekonomik. Në vitin e parë u regjistruan 586 studentë: 185 në drejtimin juridik (43 të rregullt dhe 142 me korrespondencë) dhe 401 në atë ekonomik (120 të rregullt dhe 281 me korrespondencë). Prej tyre, 323 serbë, 134 shqiptarë dhe 129 të tjerë.

Në vitin 1961 u hapen edhe dy shkolla të larta teknike: *Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë*, ku u regjistruan 364 studentë (87 të rregullt, 277 me korrespondencë), dhe *Shkolla e Lartë Teknike*

whom were Albanians, were registered. In 1962, the Prizren HPS became independent. The Prishtina HPS established a Centre for part-time studies in Novi Pazar, with 50 students.

A year after the Prishtina HPS (1959), *the Higher Administration School* was opened in Prishtina. In the two first academic years, there were 184 full-time and 407 part-time students in this school.

Then came *the Higher Economic-Commercial School in Peja* (1960), in which, 362 students (186 full-time and 176 part-time) attended their studies in the first and second year.

In the same year (1960), *the Higher Agricultural School in Prishtina* was established. In the academic year 1961/62, 165 full-time and 395 part-time students were registered.

In October 1960, the first faculty – *the Faculty of Philosophy in Prishtina* was established with six groups: the groups of Albanological Studies, Serbo-Croatian Language, Mathematics, Physics, Chemistry and Biology. After a short time, additional groups were opened: Russian Language and Literature and English Language and Literature. In the first academic year, 1960/61, 97 full-time students (60 Albanians, 32 Serbs and 5 others) and 141 part-time students were registered. Lectures were performed by 7 teachers (2 Albanians and 5 Serbs) and 7 associates (2 Albanians and 5 Serbs). Four of them were doctors of sciences and one with a master degree.

In the following year (1961), *the Faculty of Economics and Law* was founded in Prishtina, with two branches: Law and Economics. In the first year, there were registered 586 students: 185 in the Law Branch (43 full-time and 142 part-time), and 401 students in the Branch of Economics (120 full-time and 281 part-time). Of them, 323 were Serbs, 134 Albanians and 129 others.

In 1961 two other higher engineering schools were opened: *the Higher Engineering School in*

në Mitrovicë, ku u regjistruan 51 studentë (33 të rregullt, 18 me korrespondencë).

Në katër shkollat e larta dhe në dy fakultete të hapura deri në vitin 1961, studionin 3.320 studentë (1.046 të rregullt dhe 2.274 me korrespondencë), prej të cilëve 2010 serbë, 928 shqiptarë dhe 382 të tjerë.

Në vitet e gjashtëdhjeta u themeluan edhe disa institucione të tjera të arsimit të lartë: *Shkolla e Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" në Prizren* (1962), *Fakulteti Teknik në Prishtinë* (1965), *Shkolla e Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" në Gjakovë* (1967) dhe *Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë* (1969). Kështu, institucionet pararendëse të arsimit të lartë në Kosovë ishin katër fakultete dhe tetë shkolla të larta.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe sigurimit të kapaciteteve të strehimit dhe të ushqimit të studentëve. Fillimisht u adaptuan disa objekte ekzistuese, ndërkohë që në vitin 1961 u ndërtua Konvikti nr.1 i studentëve, pas të cilit u ndërtuan edhe objekte të tjera, me kapacitet 750 shtretër, ku mund të banonin afro 1000 studentë.

Mësimi në fakultete dhe në shkolla të larta (me disa përjashtime) zhvillohej në gjuhën serbo-kroate. Kuadri mësimor në gjuhën shqipe ishte i pakët. Mësimi në gjuhën shqipe në disa degë ose në disa lëndë mësimore mbahej qysh në fillim të veprimtarisë së tyre (më 1960 vetëm në Degën e Albanistikës. Dy vjet më pas mbaheshin shqip edhe lëndët: pedagogjia e Sociologjia, si lëndë të përgjithshme në shumë grupe studimore). Mësimi shqip do të intensifikohet, sidomos nga viti 1966. U intensifikuan, gjithashtu, edhe përpjekjet për formimin e kuadrit arsimor për mësim në këtë gjuhë.

Në vitin 1964 diplomuan 31 studentë nga gjenerata e parë e studentëve të Fakultetit Filozofik, prej të cilëve 16 shqiptarë dhe 15 të tjerë.

Prishtina, in which 364 students were registered (87 full-time, 277 part-time), and *the Higher Engineering School in Mitrovica*, in which 51 students were registered (33 full-time and 18 part-time).

In four higher schools and two faculties opened to 1961, about 3,320 students attended their studies (1,046 full-time and 2,274 part-time), out of whom 2,010 Serbs, 928 Albanians and 382 others.

In 1960s, several other institutions of higher education were established: *the Higher Pedagogical School "Xhevdet Doda" in Prizren* (1962), *the Faculty of Engineering in Prishtina* (1965), *the Higher Pedagogical School "Bajram Curri" in Gjakova* (1967) and *the Medical Faculty in Prishtina* (1969). Accordingly, four faculties and eight higher schools were the preliminary higher education institutions in Kosova.

Special attention was paid to the provision of the process of students' lodging and board capacities. Initially there were adapted several existing facilities, and in the meantime the students' Dormitory No. 1 was built in 1961, and following it other students facilities were built, with a capacity of 750 beds, where about 1,000 students could live.

Lectures in faculties and higher schools (with some exceptions) were delivered in the Serbo-Croatian language. The teaching staffs in Albanian were in shortage. At some departments lectures were delivered in the Albanian language in some subjects still from the beginning of their activity (in 1960, only at the Department of Albanian Studies). Two years later, some other subjects were also instructed in Albanian: Pedagogy and Sociology (as general subjects to many studying groups). Teaching in Albanian continued to become intensified, particularly from 1966. The efforts for creation of teaching staffs in Albanian were increasingly intensified.

In 1964, 31 students graduated from the first generation in the Faculty of Philosophy, of whom 16 were Albanians and 15 others.

Me hapjen e Fakultetit Filozofik, Juridik-Ekonomik, Teknik dhe të Mjekësisë u krijuan kushtet themelore ligjore për themelimin e Universitetit të Prishtinës. Në këtë drejtim ndikuan edhe rrethanat objektive dhe ato politike në vend, sidomos pas Plenumi të Brionëve (1966), kur intensifikohen përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës për afirmim kombëtar dhe për realizimin e të drejtave politike, arsimore etj. Ato kulmuan me demonstratat e studentëve, që u shndërruan në demonstrata gjithëpopullore (1968), ku u shtruan një varg kërkesash, siç ishin kërkesa për vetëvendosje, për Kushtetutë, për themelimin e një universiteti në Prishtinë etj.

Duke pasur parasysh faktin se në Kosovë mungonin shumë kuadrot profesionale me arsim të lartë dhe universitar, të cilët i përgatitnin ato institucione të larta pedagogjike dhe shkencore, ndihma e fakulteteve të para dhe e shkollave të larta që e madhe dhe shumë e rëndësishme. Këto institucione të larta profesionale-arsimore e shkencore, që u themeluan dhe vepruan në periudhën e parë që nga vitet 1958, 1959, 1960 dhe në vitet e tjera deri më 1970, kur filloi jetën dhe veprimtarinë Universiteti i Prishtinës, dhanë një kontribut gjithnjë e më të madh në përgatitjen e ekspertëve shqiptarë me arsim të lartë, për të cilët kishte aq shumë nevojë shoqëria kosovare.

Krahas aftësimin të specialistëve të profileve të ndryshëm, shkollat e para të larta dhe ato katër fakultetet e para në Kosovë, ndikuan drejtpërdrejt (deri më 1970), por edhe gjatë dekadave që pasuan, në zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës (sidomos të gjuhësisë, të albanologjisë), artit, ekonomisë, teknikës, mjekësisë dhe të fushave të tjera.

By opening the Faculty of Philosophy, Faculty of Law and Economics, Faculty of Engineering and Medical Faculty, basic legal conditions were created for the foundation of the University of Prishtina. In this direction objective and political circumstances were created in the country, in particular following the Party Plenum of Brioni (1966), when the endeavours of the Albanian people of Kosovo were intensified for their national affirmation and the accomplishment of their political, education and other rights. They culminated with students' demonstrations which were transformed into all-national demonstrations (1968), where a series of demands were put forward, such as the demand for self-determination, for a Constitution, for the establishment of a University in Prishtina, etc.

Bearing in mind the fact that many professional staffs with higher and university education were lacking in Kosovo, who were preparing those higher pedagogical and scientific institutions, the assistance of the first faculties and higher schools was great and very important. These higher professional-education and scientific institutions, which were established and acted in the first period still in 1958, 1959, 1960 and in the following years to 1970, when the University of Prishtina began its life and activity, made their all the more increasing contribution to the preparation of Albanian experts with higher education, who were so much necessary to the Kosovar society.

Parallel to capacity building of different profiles specialists, the first higher schools and those first four faculties in Kosovo, had a direct impact (to 1970), and also during the following decades, on the development of education, culture, science (especially of linguistics, Albanian studies), art, economy, engineering, medicine and other fields of activity.

2. Themelimi i Universitetit të Prishtinës dhe veprimtaria e tij 1970-1981

Universiteti i Prishtinës “*burimisht*” është themeluar për të studiuar studentët shqiptarë në gjuhën e tyre amtare shqipe.” Kjo ishte plotësim i një kërkesë të shqiptarëve. Universitetin e Prishtinës e themeloi Kuvendi i KSA të Kosovës, i cili, më 18 nëntor 1969, nxori *Ligjin mbi themelimin e Universitetit të Prishtinës*.

Në nenin 1. të këtij ligji tekstualisht thuhet: “Themelohet Universiteti i Prishtinës. Universiteti ka cilësinë e personit juridik “.

Neni 2. i po këtij ligji saktëson: “Në përbërje të Universitetit të Prishtinës hyjnë fakultetet me seli në Prishtinë: Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridiko-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë.” (“*Fletorja zyrtare e KSAK*” nr. 33/69), Prishtinë, nëntor (1969).

Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më pas, më 15 shkurt, u mbajt mbledhja solemne e Kuvendit për përrurimin e tij. Dita e 15 shkurtit u shpall *Dita e Universitetit të Prishtinës*. Rektor i parë i tij u zgjodh Prof. dr. Dervish Rozhaja.

Gjatë viteve të shtatëdhjeta u themeluan edhe disa institucione të tjera të arsimit të lartë, ndër të cilat edhe disa fakultete. Nga Fakulteti Filozofik, më 1971, mëvetësohet *Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore*, kur mëvetësohet edhe Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik, të cilët fillimisht ishin së bashku. Në vitin 1973 u themelua edhe *Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë*, pastaj *Fakulteti Xehetar Metalurgjik në Mitrovicë* (1974), *Fakulteti i Arteve në Prishtinë* (1975), *Shkolla e Lartë Pedagogjike "Skënderbeu" në Gjilan* (1975), *Shkolla e Lartë Teknike (Qendra për Arsimin e*

2. The Foundation of the University of Prishtina and Its Activity 1970-1981

The University of Prishtina was “*originally*” founded with the intention for the Albanian students to study in their mother tongue - Albanian. This was an accomplishment of Albanians’ demands. The University of Prishtina was founded by the SAP Kosova Assembly, which approved *the Law on the Foundation of the University of Prishtina* on 18 November 1969.

Article 1 of this Law reads textually: “The University of Prishtina is established. The University has the capacity of a legal person“.

Article 2 of this Law states: “The University of Prishtina includes the faculties with their seats in Prishtina: the Faculty of Philosophy, Faculty of Law and Economics, Faculty of Engineering and the Medical Faculty.” (“*Official Gazette of the SAPK*” No. 33/69, Prishtina, November 1969).

The Foundation Assembly of the University of Prishtina was held on 13 February 1970, and two days later, on 15 February, the Solemn Meeting of the Foundation Assembly was held for its inauguration. The date 15 February was proclaimed *The Day of the University of Prishtina*. Prof. Dr. Dervish Rozhaja was elected the first Rector.

In 1970s, some other institutions of higher education were established, among which there were several faculties. From the Faculty of Philosophy, in 1971, was separated *the Faculty of Mathematical-Natural Sciences*, becoming an independent institution. At that time *the Faculty of Law and Faculty of Economics* became independent, which were initially joint institutions. In 1973 *the Faculty of Agriculture in Prishtina* was established, then *the Faculty of Mining and Metallurgy in Mitrovica* (1974), *the Faculty of Arts*

Lartë) në Ferizaj (1976), Fakulteti i Kulturës Fizike në Prishtinë (1979).

Në bazë të Marrëveshjes vetëqeverisëse të vitit 1980 Shkollat e Larta u bashkuan me Universitetin e Prishtinës.

Me rritjen e numrit të fakulteteve dhe të shkollave të larta, rritet edhe numri i studentëve, sidomos numri i studentëve shqiptarë. Në vitin shkollor 1969/70, kur u themelua, në Universitetin e Prishtinës studionin 7712 studentë (5303 të rregullt, 2409 me korrespondencë), prej të cilëve shqiptarë ishin 3669, ndërsa serbë ishin 4043 studentë. Numri i studentëve ishte i vogël, sidomos i atyre shqiptarë. Këtë e dëshmon e dhëna se në atë vit shkollor numri i studentëve shqiptarë ishte për 374 më i vogël se i atyre që studionin në gjuhën serbokroate. Ndërkaq, gjatë dhjetë vjetëve të zhvillimit të tij, Universiteti i Prishtinës u shndërrua në një qendër të fuqishme universitare, me numër të madh studentësh, sidomos në studimet në gjuhën shqipe. Në vitin akademik 1979/80 kishte 34922 studentë (25009 të rregullt, 9913 me korrespondencë). Mësimet në gjuhën shqipe i vijonin 24771 studentë, ndërsa 10151 në gjuhën serbokroate. U rrit gjithashtu edhe numri i vajzave shqiptare që studionin në fakultete e në degë të ndryshme (803 sosh).

U rrit dukshëm edhe numri i mësimdhënësve dhe i bashkëpunëtorëve, sidomos për mësim në gjuhën shqipe. Derisa në vitin shkollor 1969/70 në Universitetin e Prishtinës punonin rreth 200 mësimdhënës dhe 200 bashkëpunëtorë, në vitin akademik 1979/80 në këtë Universitet punonin rreth 600 mësimdhënës dhe 400 bashkëpunëtorë. Në marrëdhënie të rregullt pune ishin mbi 190 doktorë shkencash (126 shqiptarë) dhe 173 magjistra (134 shqiptarë).

Për një kohë relativisht të shkurtër, u krijua kadri mësimor për mbajtjen e mësimit edhe në gjuhën shqipe në të gjitha degët, përkatësisht

in Prishtina (1975), the Higher Pedagogical School "Skënderbeu" in Gjilan (1975), the Higher Engineering School (Centre for Higher Education) in Ferizaj (1976), the Faculty of Physical Education in Prishtina (1979).

On the basis of a Self-management Agreement in 1980 the higher schools joined the University of Prishtina.

By increasing the number of faculties and higher schools, the number of students was also increased, particularly the number of Albanian students. In the academic year 1969/70, when the University of Prishtina was founded, 7,712 students (5,303 full-time, 2,409 part-time) were studying there, of whom 3,669 were Albanians, and 4,043 Serbs. The number of students was small, particularly that of the Albanians. This is proved by the fact that the number of Albanian students in that academic year was for 374 smaller than the number of those who studied in the Serbo-Croatian language. However, during the first ten years of its development, the University of Prishtina was transformed into a strong university centre, with a large number of students, particularly of those studying in the Albanian Language. In the academic year 1979/80 there were 34,922 students (25,009 full-time, 9,913 part-time). Instructions in Albanian were attended by 24,771 students, and 10,151 in the Serbian language. The number of Albanian female students who studied in different faculties and higher schools increased too (803).

The number of teachers and associates increased significantly, especially for lecturing in the Albanian language. While in the academic year 1969-1970, about 200 teachers and 200 associates were working in the University of Prishtina, in the academic year 1979-1980 about 600 teachers and 400 associates were working in this University. There were more than 190 doctors of sciences (126 Albanians) and 173 masters (134 Albanians) working full-time.

lëndët mësimore. Me Kushtetutën e vitit 1974, sistemi i arsimit në Kosovë fitoi një autonomi. Në vitin 1979 u nënshkrua marrëveshja mbi bashkëpunimin në Universitetin e Prishtinës, pranë të cilit veprimtarinë e tyre e zhvilluan edhe institutet shkencore, siç ishin ai i studimeve sociologjike, i ekonomisë etj., të cilët u morën me hulumtime të çështjeve konkrete dhe më aktuale të Kosovës. Krahas kuadrove vendore, në këtë aspekt ndihmuan edhe mësimdhënësit nga Universiteti i Tiranës, sidomos në vitet 1978-1981. Për lëndët mësimore në gjuhën serbokroate profesorët e universiteteve të Beogradit, të Shkupit, të Nishit dhe ndonjë nga qendra të tjera universitare ishin të angazhuar prej themelimit të tij. Edhe gjatë këtyre dhjetë vjetëve një numër i kufizuar i mësimdhënësve nga mësimi në gjuhën serbokroate, në mungesë të kuadrit shqiptar, u mbante mësim edhe studentëve shqiptarë në gjuhën serbokroate. Mësimi dhe studimet në gjuhën joamtare, për studentët shqiptarë, paraqisnin vështirësi serioze, e që, pa dyshim, ndikoi edhe në efikasitetin e studimeve.

Me *Ligjin mbi Shkollimin e Lartë* ("Gazeta zyrtare e KSAK" nr.43/74), arsimi i lartë në Kosovë për herë të parë rregullohet në mënyrë të tërësishme. Në disa degë, si në atë të Albanologjisë, të Pedagogjisë, të Historisë, në fakultetin Juridik, në SHMN etj., u themeluan edhe studimet pasuniversitare.

Me qëllim të *intensifikimit të mëimit*, u bënë edhe hapat e parë për hartimin e teksteve universitare, që mungonin, sidomos për studimet në gjuhën shqipe. U bënë edhe përpjekjet e para për reformimin e planeve dhe programeve të studimeve dhe për krijimin e kushteve të tjera për studime dhe veprimtari shkencore. Pothuajse në të gjitha degët, në drejtimet dhe katedrat e fakulteteve, u themeluan biblioteka, salla leximi dhe u sigurua literaturë për studentët dhe

In a relatively short time, the teaching staffs for lecturing in the Albanian language in all curricula subjects were also created. By the Constitution of 1974, the education system in Kosova gained its autonomy. In 1979 an agreement on the cooperation within the University of Prishtina was signed, in which its activity was performed also by scientific institutes, in subjects such as sociology, economics etc., which dealt with research work in concrete and more up-to-date issues in Kosova. Parallel to local staffs, the teachers of the University of Tirana made their contribution in this aspect, particularly in the period 1978-1981. In the teaching subjects in Serbo-Croatian, professors from the universities of Belgrade, Skopje, Nish and some other university centre since its establishment. In the first ten years, due to the lack of Albanian staff, a certain number of teachers from the Serbo-Croatian teaching process were teaching the Albanian students in Serbo-Croatian. Teaching and studies in their non-mother tongue presented serious difficulties to Albanian students, which undoubtedly had an impact on their studies efficiency.

By the *Law on Higher education* ("Official Gazette of the SAPK" No.43/74), higher education in Kosova for the first time is regulated entirely. In some departments, as in those of Albanologic Studies, Pedagogy, History, in the Faculty of Law, Faculty of Mathematic-Natural Sciences (FMNS), etc., post-graduate studies were established.

On purpose of *intensification of teaching*, the first steps were made for compilation of university text-books, which were lacking, particularly for studies in the Albanian language. The initial efforts were done for reformation of studies curricula and creation of better conditions for studying and scientific activity. Almost in all directions, in faculty departments and sections,

mësimdhënësit, ndonëse ajo nuk ishte e mjaftueshme.

Në vitin 1974 u ndërtua edhe restoranti modern i studentëve, me lokale të tjera përcjellëse: bufe, salla e leximit, klubet, objekti i mbrojtjes shëndetësore të studentëve. Studentët u ndihmuan edhe materialisht përmes bursave dhe kredive.

Krahas punës mësimore, *u intensifikua edhe puna shkencore* në Universitet. Pranë disa fakulteteve (SHMN, Filozofik, Juridik, Ekonomik, Mjekësisë etj.) u themeluan edhe institute shkencore, klinika e shërbime shkencore. U rrit dukshëm edhe numri i doktorëve dhe i magjistrave, sidomos të atyre shqiptarë, u botuan monografi dhe vepra tjera shkencore të punonjësve universitarë, u nxorën buletine shkencore në shumë fakultete dhe u organizuan forma të ndryshme të veprimtarisë shkencore.

Universiteti i Prishtinës, nga themelimi i tij zhvilloi bashkëpunim me universitet e tjera në ish-Jugosllavi (me atë të Beogradit, të Shkupit, të Zagrebit etj.), si dhe me qendra të tjera universitare, sidomos me Universitetin e Tiranës, me të cilin filloi një bashkëpunim i frytshëm qysh nga viti akademik 1970/71 e deri në vitin 1981. Në vitin 1971 u krijuan mundësitë për bashkëpunim edhe me Universitetin “Friedrich Schiller” të Jenës (Gjermani), me Universitetin e Mahaçkallës (Dagestan, BRSS), pastaj me Institutin e Lartë të Jashit (Rumani), u vunë kontakte edhe me universitete të tjera. Universiteti i Prishtinës u bë anëtar i Konferencës së Përhershme të Rektorëve të Evropës dhe i Asociacionit Botëror të Universiteteve, ku mori pjesë aktivisht. Në afirmimin ndërkombëtar të tij ndikoi dukshëm *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* për studentë dhe studiues nga vende të ndryshme të Evropës dhe jashtë saj, që merren me probleme

libraries and reading rooms were opened, and literature was provided for both students and teachers, although it was not sufficient.

In 1974 a modern students' restaurant was built, with other following premises: buffet, reading rooms, clubs, a students' health protection facility. Students were provided material aid by scholarships and stipends.

Parallel to teaching activity, *scientific work was also intensified* in the University. At some faculties (FMNS, Philosophy, Law, Economics, Medicine, etc.) scientific institutes, clinics and scientific services were established. The number of doctors of science and masters increased, particularly of Albanian ones; monographs and other scientific works of University staffs were published, scientific bulletins were published in many faculties and different other forms of scientific activity were organised.

The University of Prishtina, since its foundation, developed its cooperation with other universities of the former Yugoslavia (with that of Belgrade, Shkup (Skopje), Zagreb, etc.), as well as with other university centres, particularly with the University of Tirana, with which a fruitful cooperation began in the academic year 1970-1971 and lasted to 1981. In 1971 possibilities for cooperation with the University “Friedrich Schiller” of Jena (Germany), with the University of Mahackala (Dagestan, USSR), then with the Higher Institute of Jasa (Romania), contact were also established with other universities. The University of Prishtina became a member of the Permanent Conference of European rectors and of the World Universities Association, where it took part in an active way. To its international affirmation contributed significantly *the International Seminar of Albanian Language, Literature and Culture* organised for the students coming from different countries of Europe and outside it, who are involved in Albanian

të gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare, i cili u themelua pranë Fakultetit Filozofik (sot: të Filologjisë), në vitin 1974. Krahas punës mësimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës, u pasurua edhe *veprimtaria sportive dhe argëtuese e studentëve*. Formohet Lidhja e Organizatave të Kulturës Fizike e Universitetit (LOKF-a), ku vepronin 20 shoqëri sportive me 11 klube, me afro 4000 anëtarë, ku u dalluan: klubi i skitarisë (1969); klubi basketbollistik “Universiteti” (femra), formuar më 1972; klubi xhudo “Universiteti” (1969), pastaj klubi i shahut, i volejbollit, i hendbollit, i pingpongut, i shenjëtarisë etj., që arriten rezultate të mëdha. Këto klube në vitin 1979 u përfshinë në Shoqërinë Sportive “Universiteti”. Për jetën kulturore-artistike të studentëve gjatë kësaj periudhe, rol të veçantë luajti Shoqëria Kulturo-Artistike e Studentëve “Ramiz Sadiku”, themeluar më 1962, e cila zhvilloi një veprimtari të pandërprerë e shumë të suksesshme në seksionet: muzikë popullore, të folklorit, dramatik në gjuhën shqipe dhe serbokroate, të orkestrës zbavitëse, të korit, të grupit letrar. Studentët botonin edhe revistat e tyre “Bota e re” dhe “Dituria”.

Gjatë kësaj periudhe, saktësisht *brenda viteve 1970-1980, në Universitetin e Prishtinës u diplomuan mbi 9500 studentë nga 46 profilet e tij dhe u mbrojtën mbi 100 disertacione të doktoratës*. Pjesa dërrmuese e tyre ishin shqiptarë.

Përkundër rezultateve të mira që u arritën në fushën mësimore dhe kërkimore-shkencore, problem i veçantë në Universitetin e Prishtinës ishte efikasiteti i ulët i studimeve, i determinuar nga mungesa e kushteve materiale, pajisjeve të nevojshme dhe laboratorike për mësim cilësor, mësimdhënie tradicionale, mungesa e teksteve dhe e literaturës tjetër mësimore, sidomos në gjuhën shqipe.

language, literature and culture issues. It was established within the Faculty of Philosophy (not Philological Faculty), in 1974. Parallel to teaching and scientific work in the University of Prishtina, students' *sports activities and entertainment* were enriched in it. The League of Organisations of Physical Culture of the University was established (LOKF), in which 20 sports associations with 11 clubs were formed, with around 4,000 members, among which the following were distinguished: the Skiing Club (1969); Basketball Club “University” (females), formed in 1972; the Club Judo “University” (1969), then the clubs of chess, volleyball, handball, ping-pong, shooting, etc., which managed to have great results. These clubs in 1979 were included into the Sports Association “University”. The Students Cultural and Artistic Association “Ramiz Sadiku” played a great role on the cultural and artistic life of the students in this period. It was established in 1962, and developed continuous and very successful activity in the sections: of Folk Music, Folklore, Drama and Albanian and Serbo-Croatian languages, of the Entertainment Orchestra, Chorus, Literary Group. Students published their reviews “Bota e re” (New World) and “Dituria” (Knowledge).

In this period, precisely within the period 1970-1980, over 9,500 students in 46 profiles graduated and over 100 dissertations were defended in the University of Prishtina. The majority of them were Albanians.

Despite the good results that were reached in the field of education and scientific research work, a particular problem of the University of Prishtina was the low efficiency of studies, determined by the lack of material possibilities, necessary equipments and laboratories for more qualitative teaching, then traditional teaching, the lack of text-books and other required teaching literature, particularly in the Albanian language.

3. Universiteti i Prishtinës në vitet 1981-1991

Periudha 1981-1991 e historikut të Universitetit të Prishtinës shënon numrin më të madh të studentëve dhe të kuadrit mësimor shqiptar, por shquhet edhe nga intensifikimi i represionit politik dhe policor serb ndaj profesorëve dhe studentëve shqiptarë, si dhe ndaj studimeve shqipe në këtë Universitet përgjithësisht.

U bënë ndryshime të llojllojshme dhe të shumta. Në vitin shkollor 1982/83 bëhet dezintegrimi i mësimit, mbi bazën e fakulteteve. Në nëntor 1987 u nënshkrua *Marrëveshja mbi bashkimin në Universitetin e Prishtinës*, me të cilën Universiteti i Prishtinës u shndërrua në një qendër universitare të fuqishme dhe shumë komplekse: me 10 fakultete, 7 shkolla të larta dhe Qendrën e Studentëve. Në vitin 1988 Fakulteti Teknik u nda në tri fakultete të veçanta: *Fakulteti i Makinerisë, Fakulteti Elektroteknik dhe Fakulteti i Ndërtimitarisë e të Arkitekturës*. Po ashtu, në vitin 1988 nga Fakulteti Filozofik u mëvetësua *Fakulteti Filologjik*.

Derisa në dhjetë vjetët e para (1970-1980) të Universitetit të Prishtinës u rrit hovshëm numri i institucioneve të arsimit të lartë, në dekadën e dytë (1981-1991) rrjeti i këtyre institucioneve u plotësua me shkolla të tjera të larta dhe fakultete, duke përfshirë këtu edhe katër fakultete të reja, të cilat u mëvetësuan.

Krahas me këtë, në fillim u rrit edhe numri i studentëve. Në vitin akademik 1980/81 numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës arriti deri 31073 me mësim në gjuhën shqipe, 12248 me mësim në gjuhën serbokroate, duke përfshirë këtu edhe 223 shtetas të huaj (kryesisht grekë). U rrit gjithashtu edhe numri i vajzave shqiptare që studionin në degë të ndryshme (6802 sosh). Numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës,

3. The University of Prishtina in the period 1981-1991

The period between 1981 and 1991 of the University of Prishtina history recorded the largest number of Albanian students and staffs, but its is also distinguished for the intensification of political and police repression against Albanian professors and students, as well as against the studies in Albanian in this University in general.

Various and numerous changes were made. In the academic year 1982-1983, there was a disintegration of teaching based on faculties. In November 1987, an *Agreement on the Unification in the University of Prishtina*, by what the University of Prishtina was transformed into a strong and very complex university centre: with 10 faculties, 7 higher schools and the Students Centre. In 1988 the Faculty of Engineering was divided into three separate faculties: *the Faculty of Mechanic Engineering, Faculty of Electrical Engineering and Faculty of Civil Engineering and Architecture*. Similarly, in 1988, *the Philological Faculty* was separated from the Faculty of Philosophy.

While in the first ten years (1970-1980) the number of higher education institutions grew rapidly in the University of Prishtina, in the second decade (1981-1991) the network of these institutions was completed with other higher schools and faculties, including also four new faculties, which became independent.

Parallel to this, initially the number of students grew up. In the academic year 1980-1981, the number of students in the University of Prishtina reached as high as 31,073, who were attending lectures in Albanian, 12,248 attending lectures in Serbo-Croatian, including also 223 foreign citizens (mainly Greeks). The number of Albanian girls studying in different departments in-

gjatë viteve që pasuan, për shkak të politikës së gabuar restriktive arsimore dhe nga frika e madhe prej inteligjencies shqiptare, do të shënojë rënie graduale. Kështu, në vitin akademik 1988/89, Universiteti i Prishtinës kishte 31598 studentë (20529 të rregullt, 11069 me korrespondencë). Mësimet në gjuhën shqipe i vijonin 24039 studentë, ndërsa në atë serbe 7559 studentë, prej të cilëve 755 të huaj (kryesisht grekë). Vetëm një vit më vonë (1989/90), numri i studentëve shqiptarë u zvogëlua për 6.434 studentë, apo për 26.76%. Nga 24039 studentë, sa ishin një vit më parë, numri i tyre ra në 17605, ndërkohë që numri i studentëve serbë mbeti i njëjtë. Universiteti i Prishtinës tashti kishte gjithsej 25091 studentë.

Në vitin shkollor 1980/81, në këtë Universitet punonin 916 mësime dhe 434 bashkëpunëtorë, ndërsa më 1988/89 kishte 1316 mësime dhe 726 bashkëpunëtorë, shumica prej të cilëve për mësimin në gjuhën shqipe. U bënë përpjekje për ngritjen e cilësisë së studimeve, posaçërisht përmes përmirësimit të kushteve të nevojshme. U rrit ndjeshëm edhe numri i teksteve universitare në gjuhën shqipe. Prej vitit 1970 – 1990 tekste universitare në pjesën më të madhe të lëndëve mësimore botohen nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës të financuara nga BVI e Arsimit dhe BVI për Punë Shkencore të Kosovës. Vetëm në vitin 1983 Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore në Prishtinë botoi (ribotoi) 60 tekste universitare.

Universiteti i Prishtinës deri në vitin 1991 arriti rezultate të konsiderueshme në fushën e arsimit, që ishte edhe detyrë parësore e tij. *Brenda periudhës njëzetvjeçare u diplomuan 46280 studentë, në të dy gjuhët mësimore. Vetëm në vitin 1988 u diplomuan rreth 3700 studentë, prej të cilëve 1200 femra.*

dicated also a remarkable increase (6,802). The number of students in the University of Prishtina, in the following years, due to a wrong education policy and due to great fear from Albanian intelligence, recorded a gradual decrease. Thus, in the academic year 1988-1989, the University of Prishtina had 31,598 students (20,529 full-time and 11,069 part-time). Lectures in Albanian were attended by 24,039 students, and those in Serbian by 7,559 students, of whom 755 were foreign students (mainly Greeks). Only a year later (1989-1990), the number of Albanian students decreased to 6,434, or for 26.76%

Out of 24,039 students, as many as they were earlier, their number went down to 17,605, while the number of Serbian students remained the same.

The University of Prishtina then had a total of 25,091 students.

In the academic year 1980-1981, this University employed 916 teaching staffs and 434 associates, while in 1988-1989 it had 1,316 teachers and 726 associates, most of them teaching in the Albanian language. Efforts were made to promote the quality of studies, particularly through the improvement of necessary conditions. The number of university text-books in Albanian grew significantly. From 1970 to 1990, the university text-books in the largest part of teaching subjects were published by the Institute of Text-Books and Teaching Means financed by the Education Self-Management Society of Interest (SMSI) and Scientific Work SMSI of Kosova. The Institute of Text-Books and Teaching Means in Prishtina published (or republished) 60 university text-books in 1983.

The University of Prishtina up to 1991 reached considerable results in the field of education, which also was its primary duty. *Within a period of twenty years, 46,280 students graduated, in both teaching languages. Only in 1988, about 3,700 students graduated, out of whom 1,200*

Në Universitetin e Prishtinës u arritën rezultate të rëndësishme edhe në fushën kërkimore-shkencore. Kështu, me veprimtari arsimore dhe shkencore në këtë institucion në vitin 1986 merreshin më shumë se 1500 punëtorë shkencorë, 1100 prej të cilëve ishin në marrëdhënie të rregullt pune. Më shumë se 400 të tyre ishin doktorë dhe po aq magjistër shkencash. Një e treta e tyre i përfundoi studimet në Universitetin e Prishtinës. Deri në vitin 1986 në Universitetin e Prishtinës doktoruan mbi 300 kandidatë dhe magjistruan 320 sish. Problem i veçantë mbeti vëllimi, dinamika, burimet dhe kualiteti i financimit të arsimit dhe të punës kërkimore-shkencore, si dhe ndërlidhja e tyre me nevojat ekonomike e shoqërore të Kosovës.

Krahas rritës së këtij institucioni, u intensifikua edhe dhuna ndaj tij, sidomos pas lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981, me të cilën u solidarizua mbarë populli shqiptar, të cilat u shoqëruan me ndërhyrje të ashpra policore, si dhe me zbatimin e orës policore në Kosovë. Në këto përleshje të përgjakshme të demonstruesve me policinë u vranë, u plagosën dhe u burgosën shumë studentë, nxënës dhe arsimtarë shqiptarë. U zhvillua, kështu, një fushatë e egër (diferencime, ndëshkime dhe përjashtime nga puna) ndaj kuadrit arsimor e studentëve shqiptarë, kundër studimeve në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës, i cili nga organet shtetërore dhe partiake jugosllave u cilësoi si “çerdhe e nacionalizmit dhe e separatizmit shqiptar”. Në këtë aspekt studentëve shqiptarë iu mohua e drejta e studimit ose u përjashtuan nga studimet 568 studentë. Në periudhën 1981/82-1990/91 numri i studentëve shqiptarë u zvogëlua për 11.068 ose 35.93%, përkatësisht nga 30.804 numri i studentëve u zvogëlua në 19.736 sish për shkak të masave ideopolitike dhe rrethanave gjithnjë e më të vështira ekonomike. Ndërkaq, në periudhë 1981-1989 u larguan 18

were females. The University of Prishtina reached substantial results in the scientific research field. Thus, more than 1,500 scientific workers were dealing with educational and scientific activity in this institution in 1986, and 1,100 of them were full-time workers. More than 400 of them were doctors of sciences and a similar number of masters of sciences and arts. One third of them completed their studies in the University of Prishtina. Up to 1986 more than 300 candidates defended their dissertations and 320 masters of sciences and arts defended their theses in the University of Prishtina. A special problem remained the volume, dynamic, sources and quality of funding education and scientific and research work, as well as their interrelation with economic and social needs in Kosova.

Parallel to the growth of this institution, violence against it was intensified too, particularly after the students' movement in the spring of 1981, with whom the whole population showed solidarity, and it was followed with harsh police intervention, and the application of the state of emergency in Kosova. In these bloody conflicts of the demonstrators against the police, many Albanian students, pupils and teachers were killed, wounded and imprisoned. In this way, a wild campaign (differentiation, punishments and dismisses from work) continued against the Albanian education staffs and students, against studying in the Albanian language in the University of Prishtina, which was qualified by Yugoslav and party bodies “as a nest of Albanian nationalism and separatism”. In this respect, the Albanian students were denied the right to study or they were expelled from schools – 568 students. In the period between academic years 1981-1982 and 1990-1991, the number of Albanian students was reduced for 11,068 or 35.93%, namely from 30,804 students their number fell down to 19,736 due to ideological-

arsimtarë shqiptarë, disa edhe u burgosën. U intensifikua edhe rezistenca ndaj kësaj dhune.

Në vitin 1990 u nxor vendimi për masat e dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga Kuvendi i Republikës së Serbisë, ndërsa në qershor 1991 u futën masat e dhunshme në Universitet dhe në fakultete.

Më 27 qershor të atij viti, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë miratoi këtë vendim: "*Për aplikimin e masave të përkohshme për mbrojtjen e të drejtave vetëqeverisëse dhe të pasurisë shoqërore ndaj Universitetit të Prishtinës dhe ndaj*

fakulteteve në përbërje të tij, Fakultetit Filologjik, Fakultetit Filozofik, Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit Elektroteknik, Fakultetit të Makinerisë, Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, Fakultetit të Bujqësisë, Fakultetit të Arteve, Fakultetit të Kulturës Fizike dhe ndaj Fakultetit Xehetar-Metalurgjik të Mitrovicës." ("Sluzbeni glasnik SRSi, nr. 38, Beograd, 27.VI.1991). Në fillim të vitit akademik 1991/92 profesorët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës nuk e nënshkruan marrëveshjen me Bashkësinë e Shkollave të Larta dhe me Bashkësinë e Fakulteteve të Serbisë. Më 1 tetor 1991 Fondi Krahinor për Arsimin e Lartë në Kosovë ndërpreu financimin e mësimi shqip në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta. Studentët dhe arsimtarët shqiptarë u përjashtuan nga Universiteti i Prishtinës.

Përjashtimi i arsimtarëve shqiptarë nga Universiteti i Prishtinës gjatë vitit 1991, në historinë e arsimit të lartë të Kosovës, do të mbetet si një akt jocivilizues, jonjerëzor dhe antishqiptar i pushtetit serb.

political measures, and the economic circumstances became increasingly difficult. However, in the period 1981-1989, 18 Albanian teaching staffs were expelled from the University; some of them were also put to prison. The resistance against such violence was intensified too.

In 1990, compulsory measures were implemented to the University of Prishtina by the Parliament of the Republic of Serbia, and in June 1991 compulsory-violent measures were imposed to the University and its faculties.

On 27 June of that year, the Assembly of the Republic of Serbia approved this decision: *For the protection of self-management rights and social property, provisional measures are implemented against the University of Prishtina and the faculties in its structure: the Philological Faculty, Faculty of Philosophy, Faculty of Mathematical-Natural Sciences, Faculty of Law, Faculty of Economics, Faculty of Electrical Engineering, Faculty of Mechanical Engineering, Faculty of Civil Engineering and Architecture, Faculty of Agriculture, Faculty of Arts, Faculty of Physical Culture, and Faculty of Mining and Metallurgy in Mitrovica.* ("Sluzbeni glasnik (Official Gazette) of the SRSi, No. 38, Belgrade, 27/06/1991). In the beginning of the academic year 1991-1992, the Albanian professors of the University of Prishtina did not sign the agreement with the Serbian Community of Higher Schools and the Community of Faculties. On 1st October 1991, the Provincial Fund for Higher Education in Kosova stopped funding education in the Albanian language in all the faculties and higher schools. Albanian students and teachers were expelled from the University of Prishtina.

The dismissal of Albanian teachers from the University of Prishtina in 1991 will remain in the history of the higher and university education of Kosova as an uncivilized, inhuman and anti-Albanian act of the Serbian authorities.

4. Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1999

Në vitin akademik 1991/92, filloi periudha e rimëkëmbjes dhe e mbijetesës së Universitetit të Prishtinës (studimeve në gjuhën shqipe) në kushte të jashtëzakonshme. Më 26 nëntor 1991 u mbajt mbledhja e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës, ku u vendos vazhdimi i mësimit në gjuhën shqipe jashtë lokaleve legale (të uzurpuara nga administrata dhe policia serbe). U zgjodh rektori i ri i Universitetit të Prishtinës, *Prof. dr. Ejup Statovci*. Në këtë kuadër u bë edhe konstituimi i organeve drejtuese të fakulteteve dhe të shkollave të larta të këtij Universiteti. Më 5 dhjetor 1991, Kolegjiumi i Dekanëve mbajti mbledhjen e parë ku u vendos për hapat që duhet marrë për organizimin e punës mësimor-shkencore në kushte të jashtëzakonshme, në lokale private. U vendos, gjithashtu që kjo veprimtari të jetë publike dhe e bazuar në dispozitat ligjore ekzistuese dhe në vendimet institucionale të Kosovës. Ndërkaq, në mbledhjen e Kuvendit të Universitetit, më 10 dhjetor 1991, rektori prof.dr. Ejup Statovci, paraqiti programin e punës dhe parashtroi vizionin e tij për organizimin e punës në këtë institucion. Kontribut të jashtëzakonshëm në nismën e aktivitetit për riorganizimin e punës në Universitet dha edhe *prof. dr. Eshref Ademaj*, me insistimin e të cilit u shpall Konkursi për regjistrimin e studentëve të rinj në vitin akademik 1991/1992. Realizimin e Konkursit dhe pranimin e studentëve të rinj e mundësuan institucionet e arsimit të lartë. Kjo bëri të mundur të vazhdojë puna legale në pranimin e studentëve e më vonë edhe në organizimin institucional në objekte private.

Bazën themelore juridike të Universitetit të Prishtinës e përbënin *Ligji mbi Arsimin e Lartë* i

4. The Survival of the University of Prishtina 1991-1999

The academic year 1991-1992, a period of the progress and survival of the University of Prishtina began (studies in the Albanian language) in exceptional conditions. On 26 November 1991, a session of the University of Prishtina Assembly was held, where it was decided to continue the teaching process in Albanian outside the legal premises (which were occupied by the Serbian Administration and Police). *Prof. Dr. Ejup Statovci* was elected new Rector of the University of Prishtina. In this framework, the constitution of the steering bodies of this University faculties and higher schools was carried out. On 5 December 1991, the Deans Collegial Body held its first meeting, at which it was decided how to proceed further in the organization of the teaching-scientific activity in extraordinary conditions, in private premises. It was also decided that this activity should be public and based on the current legal provisions and institutional decisions of Kosovo. However, at the meeting of the University Assembly, on 10 December 1991, Rector Prof. Dr. Ejup Statovci presented a working program and anticipated his vision for the organization of work in this institution. Particular contribution to the commencing of the activity in the organization of University work was also given by *Prof. Dr. Eshref Ademaj*, on whose insistence was announced a competition for registration of new students in the academic year 1991/1992. The accomplishment of the competition and registration of the new students was made possible by the higher education institutions. This made it possible for the legal work to continue in accepting new students and later institutional organization in private premises.

The basic legal activity of the University of Prishtina was based on *the Law on Higher Edu-*

KSA të Kosovës (1989) dhe Dekretligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 10 janar 1992, me të cilin legalizohej veprimtaria e Universitetit të Prishtinës në rrethana të jashtëzakonshme dhe përligjohej regjimi i ri specifik i studimeve në këto kushte. Më 22 qershor 1994, Qeveria miratoi Dekretligjin mbi Shkollimin e Lartë të Kosovës, i cili ndikoi në konsolidimin e mëtejshëm të bazës ligjore, të veprimtarisë dhe të reformimit të këtij institucioni.

Bartës të punës mësimore-shkencore në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht në 13 fakultetet dhe 7 shkollat e larta të tij, fillimisht ishin 845 arsimtarë dhe bashkëpunëtorë në marrëdhënie të përhershme pune dhe 247 sish në punë plotësuese, prej të cilëve 131 femra. Ata jetuan dhe punuan pa kushte elementare për punë, në lokale private, të ngushta, në disa ndërtesa që ishin me lagështi e pa ngrohje, në shtëpi pa mjete mësimore, pa biblioteka etj. dhe nën presion të vazhdueshëm të dhunës policore serbe. Shumë prej tyre ishin në gjendje të vështirë ekonomike. Edhe në këto kushte, ata u përpoqën për mirëvajtjen e mësimin dhe ngritjen e cilësisë së tij: hartuan dhe botuan dispensa dhe tekste universitare, disa arsimtarë magjistruan dhe doktoruan, improvizuan disa kabinete për mësim, u pranuan kuadro të reja dhe Universiteti i Prishtinës bashkëpunonte me Universitetin e Tiranës.

Studimet në Universitetin e Prishtinës, në vitin shkollor 1991/92, i vijuan 19,622 studentë: 15,826 të rregullt dhe 3,796 me korrespondencë. Njëkohësisht, po në atë vit diplomuan 1,122 studentë. Në vitet që pasuan numri i studentëve u zvogëlua dukshëm. Në vitin shkollor 1993/94 në Universitetin e Prishtinës studimet i vijonin vetëm 12,103 studentë shqiptarë (8,481 të rregullt dhe 3,622 me korrespondencë). Studentët

of the SAP of Kosova (1989) and the Decree Law on the Amendments and Supplements to the Higher Education of Kosova, adopted by the Government of the Republic of Kosova, on 10 January 1992. The University of Prishtina activity in extraordinary circumstances was legitimated and the new specific regime of studies was followed in these conditions. On 22 June 1994, the Government approved the Decree Law on Higher Education of Kosova, which influenced the further consolidation of the legal basis, the activity and reforming of this institution.

There were initially 845 full-time professors and assistants who carried on the teaching and scientific activity of the University of Prishtina, in its 13 faculties and 7 higher schools, and 247 part-time teaching staff, out of who 131 were women. They lived and worked without elementary conditions, in private small and narrow premises, some premises were damp and without any heating, in houses without teaching devices, without any libraries etc., and under continuous pressure and violence exerted by the Serbian Police forces. Many of them were in very poor economic situation. Even in these conditions, they made their efforts for teaching progress and quality: they drafted and published university text-books and, some teachers defended their master theses and dissertations, improvised some teaching cabinets; new staffs were employed and the University of Prishtina cooperated with the University of Tirana.

In the academic year 1991-1992, studies in the University of Prishtina were attended by 19,622 students: 15,826 full-time and 3,796 part-time. At the same time, 1,122 students graduated in the same year. In the following years the number of students ran down significantly. In the academic year 1993-1994, only 12,103 Albanian students (8,481 full-time and 3,622 part-time) continued their studies in the University of

jetonin dhe studionin në kushte shumë të vështira ekonomike, jetësore, shëndetësore dhe pedagogjike.

Vëmendje e veçantë iu kushtua *punës mësimore*. U bënë ndryshime të rëndësishme në planet dhe programet e mëimit dhe në regjimin e studimeve. Disa lëndë ekzistuese në fakultete e në degë të ndryshme u zëvendësuan me lëndë të reja. U krijuan lehtësi për regjistrimin e semestrit dhe u bënë lehtësime të tjera të regjimit të studimeve. Në këto kushte mësimi organizohej kryesisht përmes metodave dhe formave tradicionale (ligjërata dhe konsultime), ndonëse u bënë përpjekje edhe për punë mësimore laboratorike etj. Studentë nga Fakulteti SHMN dhe ai Mjekësisë mësimin praktik e realizuan në institucionet e Universitetit të Tiranës etj. Që t'u dalin në ndihmë studentëve, shumë arsimtarë hartuan dispensa dhe botuan rreth 150 tekste universitare në gjuhën shqipe. Në disa fakultete vazhduan edhe studimet pasuniversitare, u organizuan mbrojtje të tezave të magjistraturës dhe të doktoratës etj. Në këto kushte u bënë përpjekje për reforma të programeve e të profileve të studimeve, sidomos në disa fakultete (Ekonomik, në vitet 1992/93). U themelua edhe Fakulteti i Mësuesisë (1997).

Edhe në këto kushte, Universiteti i Prishtinës u përpoq për kultivimin e marrëdhënieve me universitetet e tjera, si me universitet e Shqipërisë. U themelua edhe *Konferenca Kombëtare e Universiteteve Shqiptare* (1994). U zhvilluan marrëdhënie edhe me Universitetin "Freidrich Schiller" të Jenës, Universitetin Teknik të Dresdenit, Universitetin e Lirë të Berlinit, Universitetin e Lublanës, Universitetin e Vjenës, Universitetin e Leçes, Universitetin e Ulmit, Universitetin e Padovës, Universitetin e Firencës, Universitetin e Zagrebit etj. Mësimdhënësit e Universitetit të Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, dhanë ndihmesë të veçantë në

Prishtina. Students lived and studied in extremely difficult economic, living, health and pedagogical conditions.

Special attention was paid to *teaching activity*. Important changes were made in the curricula and studies regime. Some existing subjects in faculties and different departments were removed and new ones were introduced. Students' semesters registration facilities were created and other studying facilities were implemented. In these conditions, teaching was organized generally through traditional methods and forms (lectures, practice and consultations hours), although efforts were made for the use of laboratories in the teaching process. The students of the Faculty of MNS and the Medical Faculty had their practical classes in the institutions of the University of Tirana, etc. In order to facilitate students' studies, many teachers compiled their text-books and about 150 such university text-books were published in the Albanian language. In some faculties, post-graduate studies continued as well, master theses and dissertations were defended. In these conditions, efforts were made for curricular reforms and new study profiles, particularly in some faculties (Economics, 1992-1993). The Faculty of Teachers Training was also established (1997).

Even in these conditions, the University of Prishtina made its efforts to cultivate relationships with other universities, such as with the universities of Albania. *The National Conference of the University of Prishtina* was established (1994). Relationships were created with the University "Freidrich Schiller" from Jena, the Engineering University of Dresden, the Free University of Berlin, the University of Ljubljana, the University of Vienna, the University Leçe, the University of Uhlm, the University of Padova, the University of Firenze, the University of Zagreb, etc. The teachers of the University of Prishtina, during that

Universitetin e Tetovës, që nga themelimi i tij (1994).

Krahas studimeve, përmes organizatës së tyre, Unioni i Pavarur i Studentëve, me ndihmën e arsimtarëve, u përpoq të ringjallë veprimtarinë e gjithmbarshme studentore në Universitet, duke përfshirë këtu edhe tribuna shkencore, ekspozita artistike, koncerte muzikore etj.

Më 18 prill 1994, Unioni i Pavarur i Studentëve rifilloi të nxjerrë edhe revistën studentore “Bota e Re”. Kjo organizatë bëri punë me vlerë edhe për afirmimin e këtij Universiteti në arenën ndërkombëtare. Kjo arriti kulmin me protestat e vitit 1997 dhe me luftën çlirimtare (1998-1999).

Nga viti shkollor 1991/92 deri në vitin shkollor 1998/99, ndonëse në rrethana të jashtëzakonshme, në Universitetin e Prishtinës diplomuan 8785 studentë. Megjithatë, përkundër entuziazmit dhe punës me shumë sakrificë nga studentët, arsimtarët etj., rezultatet e studimeve (cilësia dhe efikasiteti i tyre), në këto rrethana, nuk ishin as nuk mund të ishin të larta, sidomos në disa fusha shkencore-mësimore.

Veprimtaria mësimore, shkencore dhe artistike e Universitetit të Prishtinës në kushte të jashtëzakonshme vazhdoi deri më 21 mars 1999, kur u ndërpre përkohësisht për shkak të luftës. Në këtë luftë (në vitet 1998-1999) u vranë 322 studentë dhe 8 arsimtarë të Universitetit të Prishtinës.

5. Universiteti i Prishtinës në dritën e reformës dhe veprimtaria e tij në periudhën 1999-2005

Kjo etapë e zhvillimit të Universitetit të Prishtinës zë fill me përfundimin e luftës (10

period, made special contribution to the University of Tetova, from its very start (1994).

Parallel to studies, through their Organization, the Students Independent Union, with support of their teachers, made efforts to revive their students' general activity in the University, including scientific tribunes, art exhibitions, music concerts etc.

On 18 April 1994, the Students' Independent Union began again to issue the students review “Bota e Re” (New World). This organization performed valuable work for affirmation of this University on the international arena. This reached its peak with their protests in 1997 and the liberation war (1998-1999).

From the school year 1991-1992 to the school year 1998-1999, although in extremely disfavored conditions, 8,785 students graduated in the University of Prishtina. Nevertheless, despite the enthusiasm and work with numerous sacrifices of students and teachers, etc. the results in their studies (their quality and efficiency) in these circumstances, were not and could not be at a high level, particularly in some educational-scientific fields.

Teaching, scientific and artistic activities in the University of Prishtina in such extraordinary conditions continued to 21 March 1999, when the education process was interrupted temporarily. During that war (1998-1999), 322 students and 8 teachers of the University of Prishtina were killed.

5. The University of Prishtina in the Light of Reforms and Its Activity in the Period 1999-2005

This phase of the University of Prishtina development began after the war ended 10 June 1999,

qershor 1999), kur filloi të kthehet popullata e shpërngulur në Kosovë, e bashkë me atë edhe studentët dhe arsimtarët universitarë. *Mësimi rifilloi më 2 gusht 1999 në 14 fakultete dhe në 7 shkolla të larta të tij.* Deri më 15 tetor 1999 u bë kompensimi i mësimi të humbur për shkak të luftës gjatë periudhës mars – qershor të atij viti. Mësimi u zhvillua në objekte legale të Universitetit.

Ndërkohë, u bë edhe pranimi i studentëve të rinj dhe vazhdimi i mësimi të rregullt (në gjuhën shqipe). *Gjatë vitit akademik 1999/2000 në Universitetin e Prishtinës diplomuan 1.617 studentë,* prej të cilëve 1.205 në shkencat shoqërore-humanitare dhe 412 në shkencat natyrore-teknike. Në vitin akademik 2000/01 në Universitetin e Prishtinës i vijuan studimet 20.277 studentë, prej të cilëve 15.493 në fakultete dhe 4.784 në shkolla të larta. Të rregullt ishin 14.596 dhe me korrespondencë 5.681 studentë. Numri i studentëve të rregullt ishte përafërsisht në nivelin e vitit shkollor paraprak, ndërkaq numri i studentëve me korrespondencë u zvogëlua, ndërkohë që regjistrimi i studentëve për studime me korrespondencë u ndërpre.

Në Universitetin e Prishtinës, gjatë viteve në vazhdim, do të rritet numri i studentëve. *Kështu, në vitin shkollor 2004/05 në këtë universitet studimet i vijuan 28.832 studentë, prej të cilëve 13.236 femra dhe 15.596 meshkuj.* Nga viti në vit rritet edhe numri i studentëve të diplomuar. Vetëm nga 1 tetori 2003 deri më 30 shtator 2004 diplomuan 3013 studentë (1920 në fakultete dhe 1093 në shkolla të larta). Ndërkaq, nga gjenerata e parë e studentëve, që u regjistruan sipas modelit evropian të studimeve (Deklarata e Bolonjës), deri më 30 shtator 2004 diplomuan 249 studentë (143 në fakultete dhe 106 në shkolla të larta).

Në vitin shkollor 2000/01 në marrëdhënie të përhershme pune ishin 879 mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë, prej tyre 366 doktorë dhe 225

when the expelled population began returning to Kosovo and together with it also university students and teachers. *The teaching process restarted on 2 August 1999 in 14 faculties and 7 higher schools.* Up to 15 October 1999 the classes lost during the period March – June of that year due to the war were made up. The teaching process was developed in the legal premises of the University.

In the meantime, new students were registered and the regular teaching process continued (in the Albanian language). *During the academic year 1999-2000, 1,617 students graduated from the University of Prishtina,* out of whom 1,205 in social-humanity sciences and 412 of them in natural-engineering sciences. In the academic year 2000-2001, classes in the University of Prishtina were attended by 20,277, of them 15,493 in faculties and 4,784 in higher schools. There were 14,596 regular students and 5,681 part-time students. The number of regular students was close to the level of the previous academic year, and the number of the part-time students fell down, and the registration of part-time students discontinued.

In the following years, the number of students in the University of Prishtina increased. *Thus, 28,832 students continued their studies in the academic year 2004-1905, of whom 13,236 females and 15,596 males.* Each following year there was an increase of the number of graduate students. Only from 1st October 2003 to 30 September 2004, 3,013 students graduated (1,920 in faculties and 1,093 in higher schools). However, from the first generation of the students who were registered by a European studying model (Bologna Declaration), 249 students graduated to 30 September 2004 (143 in faculties and 106 in higher schools).

In the academic year 2000-2001, there were 879 full-time professors and assistants, of them 366

magjistër shkencash. Ndërkaq, me punë plotësuese ishin 296 mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë. Ndërkaq, në vitin shkollor 2004/05 në marrëdhënie të rregullt pune janë 1007 mësimdhënës (192 profesorë të rregullt, 50 profesorë të asocuar, 150 profesorë asistentë etj.), prej të cilëve 427 doktorë dhe 272 magjistër shkencash, dhe 631 mësimdhënës në punë plotësuese (122 profesorë të rregullt, 27 profesorë të asocuar etj.), prej të cilëve 276 doktorë dhe 126 magjistër shkencash.

Krahas kësaj, pas qershorit të vitit 1999 filloi një kapitull i ri në rindërtimin dhe në reformimin e sistemit të arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe arsimin e lartë, bazuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB. Kjo reformë vazhdoi të jetë pjesë integrale e transicionit të përgjithshëm të shoqërisë kosovare.

Reformat në Universitetin e Prishtinës filluan nga viti akademik 1999/2000, sidomos me *Statutin e Përkohshëm të Universitetit* (tetor 2000). Synimi i kësaj reforme gjithëpërfshirëse është arritja e standardeve të përparuara arsimore dhe shkencore, në mënyrë që Universiteti i Prishtinës të integrohet denjësisht në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë, në këtë kuadër edhe të Universitetit të Prishtinës, rëndësi të veçantë ka *Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë* (2003), i cili mbështetet në dokumentet relevante ndërkombëtare dhe synon reformimin e arsimit të lartë në Kosovë në frymën e *Deklaratës së Bolonjës* (19 qershor 1999). Sipas nenit 5.1 të Ligjit në fjalë, “bartësit publikë të arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë”, të cilat themelohen me vendimin e MASHT-it, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës. Bartësit e arsimit të lartë kanë autonominë e tyre; ata “gëzojnë të drejtën e mësimdhënies dhe në rastin e universiteteve, në punën kërkimore-shkencore në kuadër të

doctors of sciences and 225 masters of sciences. However, there were 296 part-time professors and assistants. Nevertheless, there were 1,007 full-time teachers in the academic year 2004-1905 (192 full professors, 50 associate professors, 150 assistant professors etc.), of whom 427 doctors of sciences and 272 masters of sciences, and 631 part-time teachers (122 full professors, 27 associate professors etc.), of whom 276 doctors and 126 masters of sciences.

Apart from this, following June 1999, a new education chapter in the system of reconstruction and reformation began in Kosovo, including higher education, based on Resolution 1244 of the UNSC. This reform continued to be an integral part of the general transition of Kosovan society.

Reforms in the University of Prishtina began in the academic year 1999-2000, especially with *the Provisional Statute of the University* (October 2000). The aim of this comprehensive reform is to achieve advanced education and scientific standards, so that the University of Prishtina could get integrated into the European space of supreme education.

The Law on Supreme Education of Kosovo (2003) is of special importance to the development of higher education in Kosovo, and also to the University of Prishtina. It is based on international relevant documentation and aims at a reform of higher education in Kosovo in the spirit of *Bologna Declaration* (19 June 1999). According to Article 5.1 of the Law mentioned above, “public carriers of higher education are universities and other higher education institutions”, which are established by the decisions of MEST, and approved by the Assembly of Kosovo. The carriers of higher education have their own autonomy; they “enjoy the right to teaching and in the case of universities, to scientific research work within

licencave të tyre, pa ndërhyrje të autoriteteve publike në veprimtarinë e tyre, përveç rasteve që parashihen në dispozitat e këtij Ligji.” (neni 7.1).

Me këtë Ligj krijohet baza juridike për themelimin e institucioneve private të arsimit të lartë, e kjo krijon kushte për konkurrencë dhe cilësi në këtë fushë. Ligji krijon mundësi për organizimin e mësimimit me dhe pa shkëputje nga puna, në distancë dhe forma të tjera, të parashikuara me statutin e institucionit përkatës.

Më 15 korrik 2004, Kuvendi i Kosovës miratoi edhe *Statutin e Universitetit të Prishtinës*, sipas të cilit “Universiteti është institucion publik autonom për arsimin e lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike.” Sipas këtij statuti, njësitë akademike të Universitetit janë: 1. *Fakulteti*, veprimtaria e të cilit është arsimit akademik, dhe 2. *Fakulteti i Shkencave të Aplikuara*, me programe akademike të orientuara në praktikë.

Universiteti i Prishtinës, sipas legjislacionit aktual, është një tërësi unike legale. Organet qeverisëse të tij janë: *Senati* (organi më i lartë akademik), *Këshilli drejtues* dhe *Rektori*. Modeli i ri (evropian) i studimeve.

Sipas Deklaratës së Bolonjës, ngërthen studimet themelore trivjeçare (*Bachelor*), studimet profesionale dyvjeçare (*Master*) dhe studimet shkencore profesionale trivjeçare (*Doktor i shkencave*). Filozofia themelore e tij është komunikimi midis universiteteve në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Në këtë kuadër, në Universitetin e Prishtinës, nga 1 tetori 2002, janë duke u bërë përpjekje për jetësimin e Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS). Kjo ngërthen edhe praktikën e përparuar të mësimdhënies, të studimeve dhe të

their licenses, without any intervention of public authorities into their activity, besides the rights foreseen by the provisions of this Law.” (Article 7.1)

By this Law, a legal basis is created for the establishment of private institutions of higher education, and this creates conditions for competition and quality in this field. The Law offers possibilities for organization of both full-time and part-time studies, distance studies and other forms of it, envisaged by the statutes of respective institutions.

On 15 July 2004, the Assembly of Kosovo approved *the Statute of the University of Prishtina*, according to which “the University is a public autonomous institution of higher education, which develops academic education, scientific research, artistic creation, professional advice and other fields of academic activities.” According to this Statute, the academic units of the University are: 1. *Faculty*, the activity of which is academic education, and 2. *Faculty of Applicable Sciences*, with academic programs oriented to practice.

The University of Prishtina, according to current legislation, is a unique legal unit. Its governing bodies are: *the Senate* (the highest academic body), *the Steering Committee* and *the Rector*. A new (European) studies model.

According to the Bologna Declaration, it includes basic three years studies (*Bachelor*), two-year professional studies (*Master*) and three-year professional scientific studies (*Doctor of science*). The fundamental philosophy of this is communication between universities in the European space of higher education.

In this framework, from 1st October 2002, efforts have been made to implement the European Credit Transfer System (ECTS) in the University of Prishtina. This also includes an advanced

vlerësimin në Universitet, me theks të veçantë që studenti të jetë subjekt aktiv në jetën dhe në veprimtarinë arsimore dhe shkencore të universitetit, e njëkohësisht bashkëpunëtor i mësimdhënësit.

Dokument i rëndësishëm për Universitetin e Prishtinës dhe arsimin e lartë në Kosovë, përgjithësisht, është edhe *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë*, miratuar nga MASHT, më 2004.

Reforma në Universitetin e Prishtinës solli ndryshime edhe në strukturën organizative të tij. Në vitin 2002 u themelua *Fakulteti i Edukimit*, me seli në Prishtinë, me katër qendra rajonale: Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Prizren. Në kuadër të tij u integruan shkollat e larta pedagogjike dhe Fakulteti i Mësuesisë, ndërsa shkollat e larta teknike në Mitrovicë dhe në Ferizaj, si dhe Shkolla e Lartë e Biznesit në Pejë, gjenden në procesin e reformimit, në harmoni me *Ligjin mbi Arsimin e Lartë*.

U ndërморën hapa konkretë, madje edhe të përshpejtuar për reformimin e të gjitha fakulteteve, sidomos të planeve dhe të programeve të tyre. Shkollat e larta dhe fakultetet e Universitetit të Prishtinës, sipas modelit evropian të studimeve (për Baçelor), filluan të punojnë në vitin shkollor 2001/2002, ndërsa në semestrin e dytë të vitit shkollor 2004/05 fillua studimet profesionale për master. Vazhdoi puna për botimin e teksteve universitare, ndonëse interesimi i Universitetit nuk ishte në shkallë të duhur. Struktura dhe përmbajtjet e teksteve ende shquhen për tipare tradicionaliste.

Janë duke u bërë përpjekje për aplikimin e disa formave interaktive të mësimin, për sigurimin e pajisjeve moderne mësimore, për trajnimin e arsimtarëve etj. Vazhdoi të thellohet bashkëpunimi i Universitetit të Prishtinës me universitete, institucione dhe asociacione

teaching, studying and assessment practice in universities, with special emphasis on student's being an active subject in the education and scientific life and activity of the university and at the same time teacher's associate.

An important document for the University of Prishtina and higher education in Kosovo, in general, is also *Higher Education Development Strategy in Kosova* approved by the MEST, in 2004.

The reform in the University of Prishtina brought about changes in its organizational structure. In 2002 *the Faculty of Education* was established with its seat in Prishtina, with four regional centers: Prishtina, Gjilan, Gjakova and Prizren. In its framework, the higher pedagogical schools were integrated in its framework, the higher pedagogical schools and the Faculty of Teachers Training were integrated, and the higher engineering schools in Mitrovica and Ferizaj, as well as the Higher Business School in Peja are under the process of reformation, in compliance with *the Law on Higher Education*.

Concrete steps have been undertaken even in the acceleration of reforms in all faculties, in particular of their curricula. The higher schools and faculties of the University of Prishtina began to work according to a European model of studies (for a bachelor degree), in the academic year 2001-2002, and in the second semester of the academic year 2004-2005 professional and master studies began. Work on publishing of university text-books began, although the interest of the University was not at an appropriate level. Text-books structure and contents are still characterized for being traditional.

Efforts have been made for application of some interactive teaching forms, for the provision with modern education equipment, for teachers training, etc. Cooperation of the University of Prishtina with international universities,

ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe Asociacionin e Universiteteve Evropiane, Konferencën e Rektorëve të Danubit, me Rrjetin Evropian të Arsimit në Distançë etj. Në muajt korrik-gusht 2001, pranë Universitetit të Prishtinës filloi punën *Universiteti Veror Ndërkombëtar*, me program të hapur për studentë, profesorë dhe specialistë vendas dhe të huaj, për të vazhduar edhe gjatë viteve që pasuan.

Në reformimin e Universitetit të Prishtinës, ose të fakulteteve të veçanta të tij, kontribut të veçantë japin edhe organizata (qeveritare e joqeveritare) ndërkombëtare dhe vendore, ku rol të veçantë (nga viti 1998) luajti WUS i Austrisë, pastaj UNMIK, Këshilli i Evropës, OSBE, SOROS etj. Në këtë kuadër u realizuan shumë projekte.

Tërë kjo u reflektua edhe në veprimtarinë shkencore, mësimore dhe artistike të Universitetit. Përkundër vështirësive materiale-financiare vazhdoi realizimi i projekteve të ndryshme shkencore, hartimi dhe botimi i monografive shkencore etj. Në bashkëpunim me institucione dhe asociacione ndërkombëtare u realizuan ose vazhdojnë të realizohen rreth 30 projekte, një numër i konsiderueshëm i tyre nëpër fakultete. U organizuan veprimtari të ndryshme shkencore, duke përfshirë edhe konferencën shkencore me temë: “*Universiteti dhe Shoqëria Bashkëkohore* (Prishtinë, 16-17 nëntor 2002), “*Vizioni për Fakultetin e Edukimit*” (Prishtinë, 18 shkurt 2005) etj.

Një segment shumë i rëndësishëm i reformës universitare ka të bëjë edhe me organizimin dhe veprimtarinë e studentëve, sipas rregullativës së re.

Studentët janë faktor aktiv dhe shumë i rëndësishëm i jetës, i veprimtarisë dhe i reformës së Universitetit të Prishtinës. Ata e përkrahën reformën dhe janë aktorë aktivë të saj. Ndër të tjera, ata janë në procesin e formimit të

institutions and associations has continued to get in depth, including the Association of European Universities, the Conference of Danubian Rectors, with the European Distant Education Network, etc. In the months of July and August 2001, *the International Summer University began its work within the University of Prishtina*, with an open curriculum for students, teachers and specialists both local and international, and it continued in the following years.

Special contribution to the establishment of the University of Prishtina or its special faculties is made by both international and local governmental and non-governmental organizations, where a special role (from 1998) was played by WUS Austria, then by UNMIK, Council of Europe, OSCE, SOROS, etc. Many projects have been accomplished in this framework.

All of this was also reflected on scientific, education and artistic activities of the University. Despite its material and financial difficulties, it continued the accomplishment of different scientific projects, in drafting and publishing of scientific monographs etc. In cooperation with international institutions and associations, *about 30 projects were realized or are being realized*, a considerable number of them by different faculties. Different scientific activities were organized, including the scientific conference on the topic: “*The Modern University and Society* (Prishtina, 16-17 November 2002), “*The Vision on the Faculty of Education*” (Prishtina, 18 February 2005) etc.

A very substantive segment of university reforms has also to do with the organization and activities of students, according to the new regulatory.

Students are an active factor and very important in the life and activity and the reform of the University of Prishtina. They support the reform and are its active actors. Among other things,

parlamentit pluralist të tyre dhe të përfaqësimit përkatës në Senatin e Universitetit. *Unioni i Pavarur i Studentëve* të Universitetit të Prishtinës, gjatë këtyre viteve të pasluftës, zhvilloi një veprimtari të dendur në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndër të tjera, më 14 shkurt 2005, studentët e universiteteve në hapësirën gjeografike shqiptare formuan *Unionin e Studentëve Shqiptarë*, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit dhe të integritimit në shkallë kombëtare.

Ndonëse dëshira për reformë rrënjësore të Universitetit të Prishtinës, sipas standardeve të përparuara evropiane, është e pranishme, janë të pranishëm faktorë të tjerë, ata të cilët i ngadalësojnë ato procese. Reforma do të ishte më e suksesshme, sikur të shoqërohej edhe me mbështetje përkatëse e financiare, me kapacitete hapësinore në harmoni me numrin e studentëve, me pajisje dhe teknologji bashkëkohore të mësimin, me aftësimin dhe trajnimin e arsimtarëve për përsosjen e mësimdhënies etj. Reforma e mirëfilltë dhe rrënjësore e Universitetit të Prishtinës është një çështje madhore, andaj dhe një aktivitet serioz, siç është kjo, duhet të jetë preokupim mbarëkosovar.

6. Disa konsekuenca të përgjithshme të Universitetit të Prishtinës

Të shumta janë rezultatet dhe vlerësimet që dalin nga veprimtaria dhe zhvillimi tridhjetepesëvjeçar i Universitetit të Prishtinës. Nga ato do të veçonim disa me rëndësi të veçantë.

Rëndësia e parë ka të bëjë me *rrugën e zhvillimit*, dhe gjatë disa dekadave me *shtrirjen e rrjetit të institucioneve të arsimit të lartë* (shtatë shkolla të larta dhe 14 fakultete), të cilat kanë vepruar

they are in the process of formation of their *Pluralistic Parliament* and of an appropriate representation to the University Senate. *The Students Independent Union* of the University of Prishtina, during these post-war years, has developed a dense activity at the national and international levels. In addition, on 14 February 2005, the students of the universities in the geographic space of Albanians formed *the Albanian Students Union*, on purpose of intensification, cooperation and integration at the national level.

Although the desire for a radical reform of the University of Prishtina, in compliance with European advanced standards is present, other factors are also present, those that slow down these processes. A reform would be much more successful if it were had appropriate financial support, with capacities of premises in accordance with the number of students, with modern equipment and technology of teaching, with capacity building and training of teachers in teaching improvement, etc. A genuine and radical reform of the University of Prishtina is a great issue, therefore a serious activity, so that it should be an all Kosovan preoccupation.

6. Some General Consequences to the University of Prishtina

The results are numerous and estimations coming out of the thirty-five years activity and development of the University of Prishtina. Out of these we would point out some of particular importance.

The first importance has to do with the *development path*, and within several decades of *stretching the higher education institutions*

në Prishtinë, si qendër universitare, por disa fakultete dhe shkolla të larta gjithnjë e më shumë edhe në qytete të tjera kosovare.

Duke u nisur nga vitet e para të ekzistimit dhe të veprimtarisë së shkollave të larta, si SHLP e Prishtinës (1958), nga fakultetet e para, përkatësisht nga Fakulteti Filozofik (1960) etj. e deri te formimi i Universitetit të Prishtinës (1970) dhe rruga e tij e zhvillimit, në shumë aspekte komplekse, deri në ditët tona, hulumtuesit e mirëfilltë dhe njohësit e kësaj fushe, në radhë të parë, me të drejtë theksojnë tezën themelore se Universiteti i Prishtinës shkoi vazhdimisht duke u zhvilluar, se fakultetet e tij u pasuruan me profile të reja studimi (grupe, degë, katedra, departamente etj.) dhe se përmes riorganizimit të formave ekzistuese të mësimin në institucionet e arsimit të lartë, ky universitet ndryshoi përmbajtësisht, arriti rezultate të konsiderueshme në fushën shkencore e atë profesionale-pedagogjike dhe u afirmua gjithnjë e më shumë.

Rezultati i dytë, gjithashtu i rëndësishëm, i zhvillimit dhe i veprimtarisë së Universitetit të Prishtinës ka të bëjë me faktin se *përmes arsimimit të shumë gjenerata studentësh të diplomuar solli ndryshime të thella në Kosovë dhe kontribuoi shumë në zhvillimin kulturor, civilizues, arsimor, kombëtar, ekonomik, artistik dhe në prosperitetin e gjithmbarshëm të Kosovës dhe të të gjitha trevave të saj. Me bindje të thellë mund të konstatohet se themelimi dhe afirmimi gjithnjë e më i madh i Universitetit të Prishtinës përbën asociacionin më të rëndësishëm të arsimit të lartë dhe, pa dyshim, bëri ndryshime të mëdha si në mjediset urbane, ashtu edhe në ato rurale.*

Do të ishte shumë i ngushtë, përkatësisht jopërkatës, konstatimi se veprimtaria, rëndësia dhe ndikimi i Universitetit të Prishtinës ishin të kufizuara vetëm në mjediset ku vepronin fakultetet e shkollat e larta, ose vetëm në Kosovë.

network (seven higher schools and 14 faculties), which acted in Prishtina, as a university centre, but some faculties and higher schools acted all the more in other Kosovan cities as well.

Higher education started to develop its activities from the first years of the existence of higher schools, such as the Higher Pedagogical School (HPS) in Prishtina (1958), then the first faculties, i.e. from the opening of the Faculty of Philosophy (1960) etc. to the establishment of the University of Prishtina (1970) and its developing path, the genius researchers and those who know this field in many complex aspects, to the present days. We point out first of all the basic thesis that the University of Prishtina continued its development permanently. Its faculties were enriched with new profiles of studies (groups, departments, sections etc.) and through the reorganization of the existing forms of teaching in higher education institutions. This University changed in its content, reached considerable results in the scientific and professional and pedagogical fields and was increasingly affirmed.

The second important result of development and activity of the University of Prishtina is related to the fact that *deep changes were made in Kosova through education of many generations of graduate students, and so it made its great contribution to cultural, civilization, educational, national, economic, artistic development and to the overall prosperity of Kosova and all of its areas. It can be found with deep conviction that the establishment and the increasing affirmation of the University of Prishtina presents the most important association of higher education and undoubtedly it made great changes in both urban and rural environments.*

It would be very narrow, namely inadequate, to conclude that the activity, importance and influence of the University of Prishtina were confined only to the environment where faculties

Universiteti i Prishtinës për më shumë se tri dekada përgatiti kuadro të larta profesionale dhe pedagogjike, të rëndësishme edhe për shumë treva të tjera, si p.sh. në Mal të Zi, Sanxhak, Maqedoni, trevat shqiptare e të tjera në Serbi etj. Në disa periudha të mëparshme përgatiti kuadro me arsim të lartë profesional edhe për nevojat e vendeve të tjera, sidomos të Greqisë.

Rezultati i tretë i Universitetit të Prishtinës, i cili do theksuar në mënyrë të veçantë, është *kontributi i tij në formimin e kuadrove profesionale e shkencore shqiptare*, të cilat në të kaluarën ishin aq të nevojshme për të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe të punës. Deri në vitet e gjashtëdhjeta, madje edhe të viteve të shtatëdhjeta të shek. XX, kuadrot me arsim universitar në Kosovë ishin të pakëta. Mungonin sidomos kuadrot shqiptare me kualifikim profesional universitar, si, mjekët, inxhinierët, profesorët, ekonomistët, juristët, agronomët, artistët dhe profesionistët e tjerë. Ndonëse nevojat për kuadro të tilla në masë të konsiderueshme janë plotësuar, ende nuk janë realizuar të gjithë objektivat e dëshiruar, sepse p.sh. për nevojat e arsimit (fillor dhe të mesëm) në shumë shkolla të komunave të Kosovës ka mungesë të profesorëve të diplomuar për gjuhën angleze, matematikë, fizikë, etnologji, psikologji, art muzikor, defektologji dhe lëndë të tjera deficitare. Nga viti shkollor 1969/70, viti i themelimit të Universitetit të Prishtinës, kur diplomuan 153 studentë në fakultetet dhe shkollat e larta, dhe deri në vitin shkollor 2003/04, në këtë institucion të arsimit të lartë *diplomuan 51.936 studentë profilesh të ndryshme*.

Është evident dhe shumë i qartë edhe ndikimi i masave drastike të organeve arsimore dhe policore të Serbisë (mbyllja e shkollave dhe e paraleleve në gjuhën shqipe, përjashtimi me dhunë i profesorëve, i bashkëpunëtorëve dhe i studentëve shqiptarë nga Universiteti etj.),

and higher schools acted, or only in Kosova. The University of Prishtina has, for more than three decades, prepared high professional and pedagogical staffs, important also to many other regions, such as, Montenegro, Sanjak, Macedonia, other Albanians' regions in Serbia, etc. In some earlier periods, it trained staffs with higher professional education also to other countries, particular to Greece.

The third result of the University of Prishtina, which ought to be emphasized in particular, is *its contribution to creation of Albanian scientific and professional staffs*, who were so much needed in the past in all the fields of social life and activity. Up to 1960s, and even in 1970s of the 20th century, the staffs with university education were very scarce. Albanian staffs were lacking in particular with university professional education, such as physicians, engineers, professors, economists lawyers, agronomists, artists and other professions. Even though the needs for such staffs have been met to a considerable degree, all the desired objectives have not been accomplished yet, as, for example, primary education needs (for primary and secondary schools). In many schools of Kosova municipalities there is lack of graduate professors of English, mathematics, physics, ethnology, psychology, musical art, defectology and other deficient subjects. Since the academic year 1969-1970, the year of the establishment of the University of Prishtina, when 153 students of faculties and higher schools graduated, *51,936 students of different profiles graduated* in this institution of higher education to the academic year 2003-2004.

The influence of drastic measures of Serbian education and police bodies (closing schools and classes in the Albanian language, forceful expulsion of Albanian professors, assistants and students from the University etc.), particularly

sidomos lufta në Kosovë (1997-1999) dhe pasojat e saj (shpërngulja e dhunshme dhe vrasja e qytetarëve shqiptarë). Vetëm gjatë luftës u vranë tetë arsimtarë universitarë dhe më shumë se 300 studentë, gjë kjo e cila la gjurmë të thella dhe u manifestua shumë negativisht në arsimin dhe shkollimin në Kosovë në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe arsimin universitar.

Rezultat tjetër i Universitetit të Prishtinës, që duhet theksuar, është edhe *reforma universitare, përpjekjet e periudhës së fundit që në shkallë universiteti dhe në fakultete të veçantë të bëhen ndryshime të nevojshme dhe të futen risi në drejtim të përparimit dhe të ngritjes së cilësisë së mësimin dhe të punës kërkimore-shkencore në frymën e Deklaratës së Bolonjës, jetësimit të saj në kushtet tona specifike.*

Gjatë procesit të reformimit të mësimin universitar dhe të riorganizimit të sistemit të shkollimit të lartë, sidomos është i domosdoshëm hulumtimi ekipor i kaheve të mëtejme dhe i orientimeve të Universitetit, të institucioneve të veçanta të arsimit të lartë në kuadër të tij dhe bartësve të atij arsimit.

Përkitazi me perspektivën dhe reformimin e Universitetit të Prishtinës gjatë viteve të fundit, gjithnjë e më shumë theksohet nevoja që të themelohet edhe një universitet tjetër publik në Kosovë, në ndonjë qytet tjetër, qytet i cili ka traditë të shquar arsimore dhe kulturore, ka bazë më të favorshme kadrovike, kushtet hapësinore, materiale etj.

Universiteti i Prishtinës edhe në të ardhmen do t'i përkrahë idetë dhe propozimet pozitive dhe racionale, gjithsesi në bazë të elaborateve e projekteve paraprake të argumentuara. Ai do të jetë institucion i mendimit të lirë. Çështja e bashkëkohësimit të mësimin në arsimin e lartë, ndërlidhja e Universitetit me perspektivën e zhvillimit të Kosovës, idealet dhe vlerat morale

the war in Kosova (1997-1999) and its consequences (forceful expulsion and killing of Albanian citizens are evident and very obvious). Only during the war, eight university professors and more than 300 students were killed, which left deep traces and was manifested very negatively in the education at all levels in Kosova, including university education.

Another consequence that ought to be pointed out about the University of Prishtina is *the University reform, the efforts of the last period for necessary changes and introducing innovations at the University level and special faculties* in the direction of improvement and raising of teaching quality and scientific research work in the spirit of the Bologna Declaration, its implementation in our specific conditions.

During the process of reforming the university education and reorganization of the higher education system, it is particularly necessary to have team research work on the further direction and orientation of the University and specific institutions of higher education within its own and its carriers' framework.

Regarding the perspective and reform of the University of Prishtina in the last years, it has been increasingly emphasized the need for the establishment of another public university in Kosova, in some other city, which is distinguished for education and cultural tradition, and has a more favorable staff basis, environmental and material conditions, etc.

The University of Prishtina will also support the positive and rational ideas and proposals in the future, naturally on the basis of preliminary grounded elaborations and projects. It will be an institution of free mind. The issue of teaching in higher education, liaison of the University with the development prospective of Kosova, moral ideals and values of our youth, the modus of better training a new student from the practical

të rinisë sonë, si të aftësohet më mirë studenti i ri në aspektin praktik dhe në mënyrë më efektive – janë vetëm disa nga temat që meritojnë hulumtime serioze, të mbështetura në metodologjinë shkencore.

Tridhjetepesë vjet të ekzistimit dhe të veprimtarisë së Universitetit të Prishtinës kapin një periudhë relativisht të shkurtër, të shoqëruar edhe me vështirësi të ndryshme, por njëkohësisht edhe me arritje, suksese dhe vlera të pakontestueshme. Natyrisht, me një bazë më të mirë materiale të mësimin në shkollimin e lartë dhe të punës shkencore, me organizim më bashkëkohor të arsimit universitar, me kuadër më cilësor profesional dhe pedagogjik dhe me disa parakushte të tjera, rezultatet e Universitetit të Prishtinës do të ishin edhe më të mëdha dhe më të shumanshme.

aspect and efficiently – are only some of the topics requiring serious research, based on scientific methodology.

Thirty-five years of the existence of the University of Prishtina embrace a relatively short period, associated with different difficulties, but at the same time it is an achievement, success and undeniable value. Naturally, with a better material basis, teaching and higher education and scientific work, with more up-to-date organization of university education, with more qualitative professional and pedagogical staffs and some other preconditions, the results of the University of Prishtina could be much better and more diverse.

**II. PËRFSHIRJA E GJENERATAVE
NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

**II. INCLUSION OF GENERATIONS
INTO THE UNIVERSITY OF PRISHTINA**

II. PËRFSHIRJA E GJENERATAVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Çështja e përfshirjes së gjeneratës së të rinjve në arsimin e lartë në Kosovë shumë herë, sidomos në vitet e 80-ta është politizuar tej mase. Sipas disa analitikëve, në Kosovë numri i studentëve, në krahasim me numrin e banorëve, ishte më i madh se në çdo vend tjetër të ish-Jugosllavisë, bile, sipas disave, edhe më i larti në Evropë. Mirëpo, a ka pasur shumë a pak studentë në Kosovë varet prej kritereve me të cilat është qasur kjo problematikë. Nëse merret për bazë numri i studentëve në numrin e përgjithshëm të banorëve, ndoshta një konstatim i tillë mund të qëndrojë, meqë, siç dihet, Kosova ka popullatë të re në strukturën e përgjithshme. Pjesa më e madhe e banorëve të Kosovës është nën moshën 25 vjeçare. Por, nëse merret për bazë shkalla e përfshirjes së gjeneratës në arsimin e lartë, atëherë lirisht mund të thuhet së kemi shkallën më të ulët të përfshirjes së gjeneratës në rajon e më gjerë.

Shumë herë në jetën e përditshme, por edhe në paraqitjet publike të zyrtarëve kosovarë dhe universitarë, është ngatërruar çështja e përfshirjes së gjeneratës. Disa prej tyre si gjeneratë e konsideronin numrin e nxënësve që e mbaronin arsimin e mesëm. Nisur nga ky aspekt, në përfshirjen e gjeneratës së maturantëve Kosova qëndron shumë lart në krahasim me vendet e tjera, sepse në Kosovë shkollën e mesme rëndom mbarojnë vetëm rreth 35-40 përqind. Shtrohet pyetja: cila është gjenerata dhe si kuptohet përfshirja e gjeneratës në vendet e tjera.

II. INCLUSION OF GENERATIONS INTO THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

The issue of inclusion of young generations into the higher education in Kosovo was many times, especially in 1980s, extremely politicized. According to some analysts, the number of students in Kosovo, in comparison to the number of its inhabitants, was larger than in any other region in the former Yugoslavia, and according to someone, it was the highest in Europe. However, if there were more or less students in Kosovo depends on the criteria by which this problem was approached to. If the number of students is taken in comparison to the number of the inhabitants, perhaps such a conclusion can be true, since, as it is known, Kosovo has a young population in its general structure. The largest part of the population of Kosovo is under 25 years old. Nevertheless, if the inclusion level of a generation in higher education is taken into account, then one may freely say that we have the lowest level of generation inclusion in the region and wider.

Many times in the daily life, but also in public presentations of Kosovan and university officials, the issue of inclusion of generations was confused. Some of them consider a students generation to be the number of students completing secondary education. Starting from their aspect, Kosovo stands too high in the generation inclusion of those who completed secondary schools in comparison to other countries, because in average only 35-40 per cent of school children complete secondary school in Kosovo. A question is put forward: which is the generation

Kur të flitet dhe të shkruhet për përfshirjen e gjeneratës në nivele të arsimit, mendohet në gjeneratën e të lindurve. Gjenerata e të lindurve është si një njësi matëse, andaj nuk duhet të identifikohet me gjeneratën e gjysmëmaturantëve apo të maturantëve, sepse shkalla e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm ndryshon prej vendit në vend. Në shumicën e shteteve evropiane shkalla e përfshirjes së gjeneratës në arsimin e mesëm është mbi 90 për qind, kurse në Kosovë asnjëherë nuk ka arritur të përfshihet 50 përqindëshi i gjeneratës. Në vitet e 90-ta përfshirja e gjeneratës në arsimin e mesëm ishte rreth 35-40 për qind, kurse e maturantëve rreth 30 për qind. Pra, nëse merret për bazë shkalla e përfshirjes së maturantëve, ekziston një përqindje e lartë, sepse nga 12.000-14.000 nxënës, që mësatarisht e kryejnë shkollën e mesme në arsimin e lartë, regjistrohen 6000 – 7000 studentë ose rreth 50 për qind e maturantëve. Në vitet e tetëdhjeta rreth 60 për qind e maturantëve është regjistruar në arsimin e lartë në Kosovë, çka do të thotë së përfshirja e gjeneratës së maturantëve është e lartë.

Për ndryshim nga shkalla e lartë e përfshirjes së maturantëve, shkalla e përfshirjes së gjeneratës së të lindurve në këtë nivel të arsimimit është shumë e ulët. Këtë konstatim do ta paraqesim në vazhdim, duke përcjellë gjeneratën e të lindurve nga klasa e parë deri në vitin e tretë apo të katërt të fakultetit:

Në vitin shkollor (akademik) 1970/71 në Universitetin e Prishtinës ishin të regjistruar gjithsej 10.368 studentë të rregullt dhe me korrespondencë. Nga ata të rregullt ishin 7283 studentë ose 70.24 për qind nga numri i përgjithshëm i studentëve, kurse me korrespondencë ishin 3085 studentë, ose 29,76 për qind. Ky numër i studentëve ishte nga të gjitha trojet shqiptare të ish Jugosllavisë, numri i të cilëve nuk ishte i vogël.

and how the generation inclusion is understood in other countries.

When it is spoken and written about the generation inclusion at education levels, it is thought of the birth generation. The birth generation is a unit of measurement, therefore it should not be identified to either the generation of those completing primary education nor secondary education, as the degree of the inclusion of the secondary education students is different from one country to another. In most of European countries the level of secondary school generation inclusion is over 90 per cent, and it has never reached to be 50 percent in Kosova. In 1990s, generation inclusion into secondary education was about 35-40 percent, and only about 30 percent completed secondary education. Therefore, if the level of the students who complete secondary schools is taken into consideration, it will be a high percentage, since out of 12,000-14,000 students that in average complete secondary education, only 6,000 – 7,000 students, or about 50 per cent of them, are included or registered in higher education. In 1980s, about 60 per cent of those completing secondary education were registered in higher education of Kosova, which means that the inclusion of the students completing secondary school is high.

Unlike the high level of inclusion of those completing secondary education, the level of inclusion of birth generation at this education level is very low. This finding will be presented further, following the birth generation from the first year of primary school to the third or fourth year of university studies.

In the academic year 1970-1971, there were 10,368 both full-time and part-time registered students in the University of Prishtina. Of them, 7,283 students were full-time or 70.24 percent of the total number, and there were 3,085 part-time students, or 2.76 percent. This number of students included those coming from all the

Në këtë vit shkollor në arsimin e lartë ishte përfshirë gjenerata e të lindurve në vitet 1949, 1950, 1951 dhe 1952. Në këto katër vjet në Kosovë kanë lindur 112.298 fëmijë (janë hequr të vdekurit). Shkalla e përfshirjes së përgjithshme të kësaj gjenerate, duke llogaritur studentët e rregullt dhe ata me korrespondencë, ishte 9,23 për qind, kurse si studentë të rregullt ishin përfshirë vetëm 6,48 për qind. Mirëpo, edhe kjo shkallë e përqindjes nuk është reale, meqë, në numrin e përgjithshëm të studentëve, rreth 15-20 për qind e tyre ishin nga viset jashtë Kosovës.

Vitet e lindjes	Numri i të lindurve	Gjithsej nga gjenerata	Numri i studentëve	Përfshirja e gjeneratës
1949	27435	112.298	10.368	9.23 %
1950	30245			
1951	24196			
1952	30422			

Në vitin shkollor 1981/82 numri i studentëve të rregullt dhe me korrespondencë kishte arritur në 40.371 sish. Si studentë ishin evidencuar edhe ata të cilët kishin statusin e studentit, por ishin pasiv, sepse me vite të tëra nuk u nënshtroheshin provimeve. Krahas numrit të studentëve, është shtuar edhe numri i të rinjve të gjeneratës së të lindurve në vitet 1960, 1961, 1962 dhe 1963 në 143.004. Duke krahasuar numrin e studentëve dhe numrin e të rinjve të gjeneratës, mund të konkludohet se në këtë vit akademik ishin përfshirë 28,23 për qind të gjeneratës. Sipas shënimeve zyrtare statistikore, prej 40.371 studentëve që studionin në Universitetin e Prishtinës 6.623 studentë ishin nga trevat jashtë Kosove.

Megjithatë, gjendja reale e përfshirjes së gjeneratës duhet të merret vetëm ajo e studentëve të rregullt. Kështu, prej gjithsej 26.037 stu-

regions where Albanians lived in the former Yugoslavia, and the number of them was not small.

In this academic year, the generations born in 1949, 1950, 1951 and 1952 were included. In these four years 112,298 (without deceased) babies were born in Kosova. The general level of inclusion of this generation, counting both full-time and part-time students, was 9.23 percent, and only 6.48 per cent of them were included as full-time students. However, this level of inclusion is not real either, as about 15-20 percent of the total number of students came from the regions outside Kosova.

Years of birth	Number of births	Total from generations	Number of students	Generation inclusion
1949	27435	112.298	10.368	9.23 %
1950	30245			
1951	24196			
1952	30422			

In the academic year 1981-1982, the number of both full-time and part-time students reached to 40,371. This number of students included even those who still had a student's status but were passive, as they did to take exams for years. Parallel to the number of students, the number of the youth of birth generation increased in 1960, 1961, 1962 and 1963 to 143,004. Comparing the number of students and the number of the youth of the generation, one may conclude that 28.23 percent of the generation were included in that academic year. According to official statistical records, out of 40,371 students who were studying in the University of Prishtina, 6,623 of them were not from Kosova.

Nevertheless, the real situation of generation inclusion should be taken only that of full-time students. Thus, out of a total of 26,037 full-time

dentëve të rregullt, nga Kosova ishin 22.018, ndërsa nga viset e tjera të ish-Jugosllavisë ishin 4.019 studentë, ose 15,46 për qind. Pra, përfshirja e gjeneratës së të lindurve kosovarë ishte 15,40 për qind.

Vitet e lindjes	Numri i të lindurve	Gjithsej nga gjenerata	Numri i studentëve	Përfshirja e gjeneratës
1960	36113	143.004	Gjithsej 26.037) 22.018 studentë kosovarë	15.40 %
1961	35453			
1962	35264			
1963	36164			

Numri i përgjithshëm i studentëve pas dhjetë vjetësh, në vend që të shtohet me dinamikën e shtimit të të rinjve të kësaj moshe, në vitin shkollor 1990/91 ishte zvogëluar për 11.355 sish apo për 28,13 për qind. Numri i studentëve të rregullt kishte rënë për 5.029 veta, ose për 19,31 për qind. Kështu, në këtë vit shkollor ishin të regjistruar 29.016 studentë, prej tyre 21.008 studentë ishin të rregullt. Nëse këtij numri ia heqim rreth 15 për qind të studentëve nga viset e tjera të ish-Jugosllavisë, atëherë del se studentë të rregullt kosovarë ishin 17.857 sish. Shkalla e përfshirjes së gjeneratës së të lindurve në vitet 1969, 1970, 1971 dhe 1972 (169.321) ishte 10,55 për qind.

Në vitet e nëntëdhjeta shkalla e përfshirjes së gjeneratës se të lindurve ka rënë nën 10 për qind. Në disa vite ajo ishte rreth 5 e 6 për qind.

students, 22,018 were from Kosova, and 4,019 students, or 15.46 percent, were from other regions of the former Yugoslavia. Therefore, the generation inclusion of those born in Kosova was 15.40 percent.

Years of birth	Number of births	Total from generations	Number of students	Generation inclusion
1960	36.113	143.004	(Total 26.037) 22.018 Kosovan	15.40 %
1961	35.453			
1962	35.264			
1963	36.164			

The total number of students ten years later, instead of being increased along the dynamics of increase of this age youth, it was decreased to 11,355 students or to 28.13 percent in the academic year 1990-1991. The number of full-time students came down to 5,029 students, or to 19.31 percent. Therefore, in that academic year, 29,016 students were registered, and 21,008 of them were full-time students. If this number is deducted about 15 percent students coming from other regions of the former Yugoslavia, it comes that 17,857 full-time students were from Kosova. The degree of birth generation inclusion in 1969, 1970, 1971 and 1972 (169,321) were 10.55 percent.

In 1990s, the generation inclusion level was reduced to under 10 percent. For several years it was about 5 to 6 percent.

Vitet e lindjes	Numri i të lindurve	Gjithsej nga gjenerata	Numri i studentëve	Përfshirja e gjeneratës
1969	42076	169.321	17.857	10.55 %
1970	40210			
1971	42845			
1972	44190			

Një shtim më i theksuar është shënuar në 2-3 vjetët e fundit. Në vitin shkollor 2004/05 janë regjistruar gjithsej 28.832 studentë të rregullt dhe me korrespondencë (në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake). Për studentët në gjuhën serbe Universiteti i Prishtinës nuk ka shënime, kështu që nuk mund të përcaktohet saktësisht shkalla e përfshirjes së gjeneratës. Në këtë vit shkollor në arsimin e lartë janë përfshirë të rinjtë e gjeneratës së të lindur në vitet 1982, 1983, 1984 dhe 1985. Nga këto gjenerata, sipas shënimeve statistikore, janë 198.828 të rinj. Nëse këtij numri ia heqim 10 për qind, që mendohet se nuk janë shqiptarë, atëherë mund të konstatohet se në arsimin e lartë kosovar janë përfshirë 16,11 për qind nga 178.945 veta të gjeneratës.

Vitet e lindjes	Numri i të lindurve	Gjithsej nga gjenerata	Numri i studentëve	Përfshirja e gjeneratës
1982	49.399	(Gjithsej 198.828) 169.996 pa serbë	28.832	16,11 %
1983	46.208			
1984	52.322			
1985	50.899			

Sipas planit të zhvillimit të arsimit, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës në vitin 1985 për vitin 1990 deri në vitin 2000, shkalla e përfshirjes

Years of birth	Number of births	Total of generation	Number of students	Generation inclusion
1969	42.076	169.321	17.857	10.55 %
1970	40.210			
1971	42.845			
1972	44.190			

A more remarkable increase was recorded during the last 2-3 years. In the academic year 2004-1905, 28,832 both full-time and part-time students were registered (in Albanian, Turkish and Bosnian languages). The University of Prishtina does not possess records of the number of Serbian students, so that their generation inclusion cannot be determined properly. In this academic year, the youth of the generation born in the following years 1982, 1983, 1984 and 1985 was registered in higher education. In these generations, according to statistical records, there are 198,828 young people. If this number is deducted 10 percent that are thought not to be Albanians, one can conclude that 16.11 percent out of 178,945 persons of the generation are in higher education in Kosova.

Years of birth	Number of births	Total of generation	Number of students	Generation inclusion
1982	49.399	(Total 198.828) 169.996 without Serbs	28.832	16.11 %
1983	46.208			
1984	52.322			
1985	50.899			

According to a Teaching Development Plan, which was approved by the Assembly of Kosova in 1985 for the period from 1990 to 2000, the

së gjeneratës në arsimin e lartë së të lindurve të moshës 19-22 vjeçe ishte 25 për qind. Sikur të realizohej kjo përqindje, në vitin shkollor 2004/05 do të duhej të ishin përfshirë në arsimin e lartë 44.736 studentë.

Këtë shkallë të përfshirjes së gjeneratës e kanë realizuar të gjitha shtetet e rajonit e më gjerë. Ky konstatim bie ndesh me disa vlerësime të autoriteteve zyrtare se në Kosovë kemi numër të madh studentësh. Këtu shtrohet pyetja se çka do të bëjnë 85 për qind e të rinjve që nuk përfshihen në arsimin universitar, aq më parë që pjesa dërrmuese e tyre janë të papunë.

generation inclusion in higher education of those 19-22 years old was 25 percent. If this percentage was accomplished, in the academic year 2004-2005 there should be 44,736 students included into higher education.

This level of generation inclusion was accomplished by all regional states and wider. This assertion is in contradiction to some assessments of official authorities that we have a large number of students in Kosovo. Here a question may be asked: What do 85 percent of youth that cannot be included into university education, further more when the great majority of them are jobless?



STUDENTË TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

STUDENTS OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

**III. DOKTORËT DHE ANËTARËT E NDERIT TË
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

**III. DOCTORS AND MEMBERS OF HONOUR
OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA**

III. DOKTORËT DHE ANËTARËT E NDERIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

1. Doktorët e nderit

1. *Josip Broz Tito*,(31.3. 1975)
.....Kryetar i RSFJ-së
2. *Fahrudin Ali Ahmed*,(03.10. 1975)
.....Kryetar i Republikës së Indisë
3. *Akad. Dragisha Ivanoviq*,(1987)
.....Profesor i Universitetit të Beogradit
4. *Michael Weninger*,(2001)
.....Ambasador i Austrisë në Beograd
5. *Dr. Bernard Kouchner*,(29.3.2002)
.....Kryeadministrator i Kosovës (Francë)
6. *Dr. William Kerr*,(09.9.2003)
.....Kryetar i Kolegjit La Roche (SHBA)
7. *William Jefferson Clinton*,(19.9.2003)
.....President i SHBA-ve
8. *Ismail Kadare*,(21.11.2003)
.....Shkrimtar (Shqipëri)
9. *Prof. Mag. Dr. Wolfgang Benedek*, (29.9.2004)
.....Profesor në Fakultetin Juridik-Grac, Austri

III. DOCTORS AND MEMBERS OF HONOUR OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

1. Doctors of Honor

1. *Josip Broz Tito*,(31.03. 1975)
.....President of the SFRJ
2. *Fahrudin Ali Ahmed*,(03. 10.1975)
.....President of the Republic of India
3. *Acad. Dragisa Ivanovic*,(1987)
.....Professor of Belgrade University
4. *Michael Weninger*,(2001)
.....Ambassador of Austria in Belgrade
5. *Dr. Bernard Kouchner*,(29/03/2002)
.....Kosova Chief Administrator (France)
6. *Dr. William Kerr*,(09/09/2003)
.....President of College La Roche (USA)
7. *William Jefferson Clinton*,(19/09/2003)
.....President of the USA
8. *Ismail Kadare*,(21/11/2003)
.....Writer (Albania)
9. *Prof. Dr. Wolfgang Benedek*,(29/09/2004)
.....Professor of Law, Faculty-Graz (Austria)

2. Titulli anëtar nderi i Universitetit të Prishtinës - postmortum, iu dha këtyre profesorëve

1. Akademik Ali Hadrit

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm dhe guximin intelektual në shprehjen e bazuar të mendimit shkencor edhe në kohën e sfidave më të mëdha kombëtare.

2. Akademik Dervish Rozhajës

Për kontribut të jashtëzakonshëm dhe merita të veçanta për themelimin dhe vazhdimin e mbarë të punës të Universitetit të Prishtinës.

3. Prof. dr. Ejup Statovci

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm intelektual dhe njerëzor në mbrojtjen dhe mbijetesën e Universitetit në kohën e sfidave më të mëdha të çështjes sonë kombëtare.

4. Anëtar korrespondent Eshref Ademaj

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm për konsolidimin dhe mbijetesën e Universitetit në periudhën kur më së shumti i kanosej shkatërrimi.

5. Akademik Fehmi Aganit

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm dhe guximin intelektual në shprehjen e bazuar të mendimit shkencor edhe në kohën e sfidave më të mëdha kombëtare.

2. The title of an Honored Member of the University of Prishtina ñ post-mortem, was awarded to these professors:

1. Academician Ali Hadri

For his merits and exceptional contribution and intellectual courage in expressing his based scientific thought at the time of the greatest national challenges

2. Academician Dervish Rozhaja

For his exceptional contribution and special merits for the establishment and appropriate continuation of the work the University of Prishtina

3. Prof. Dr. Ejup Statovci

For his merits and exceptional intellectual and human contribution made to protection and surviving of the University at the time of the greatest challenges of our national issue

4. Part-time Academician Eshref Ademaj

For his exceptional contribution to consolidation and surviving of the University in the period when it was most threatened to destruction

5. Academician Fehmi Agani

For his merits and exceptional contribution and intellectual courage in expressing his based scientific thought in the time of the greatest national challenges

6. Akademik Gazmend Zajmit

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm gjatë viteve të sprovave më të rënda që i përjetoi si rektor, duke përkrahur fuqishëm studentët dhe personelin akademik të Universitetit.

**3. Titulli anëtar nderi
i Universitetit të Prishtinës
iu dha profesorit:**

1. Mr. Ukshin Hoti

Për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm intelektual dhe njerëzor në mbrojtjen e vazhdueshme të Universitetit në kohën e sfidave më të mëdha të çështjes sonë kombëtare.

6. Academician Gazmend Zajmi

For his merits and exceptional contribution made in the years of the most severe challenges that he experienced as a Rector, supporting strongly the University students and academic staffs

**3. The title of an Honored Member
of the University of Prishtina
was awarded to:**

1. Mr. Ukshin Hoti (MA)

For his merits and exceptional intellectual and human contribution made to continuous protection of the University at the time of the greatest challenges of our national issue



SHPALLJA E KLINTONIT
- DOKTOR HONORIS CAUSA

AWARDING AN HONORARY DOCTORATE
TO CLINTON

IV. REKTORËT E PROREKTORËT 1970-2005

IV. RECTORS AND VICE-RECTORS 1970-2005

IV. REKTORËT E PROREKTORËT 1970 - 2005

1. Rektorët

IV. RECTORS AND VICE-RECTORS 1970 - 2005

1. Rectors



Prof. dr. Dervish Rozhaja
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1969/70 – 1972/73

Prof. Dr. Dervish Rozhaja
Rector of the University of Prish-
tina 1969–1973

Lindi në Pejë, më 5 korrik 1934. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen, më 1949, në Gjakovë, kurse biologjinë në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Beogradit, në të cilin diplomoi në vitin 1954.

Gjatë vitit shkollor 1954/55 shërbeu profesor i biologjisë në Shkollën Normale të Prishtinës. Prej vitit 1955 deri në vitin 1959 kreu punën e doktorantit në Entin Fiziologjik të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Beogradit, ku doktoroi me temën **Aspekti bioenergjetik i adaptimit termik të anurave**.

Prej vitit 1960 e deri sa ishte gjallë ligjëroi Fiziologjinë krahasuese në Katedrën e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Filozofikut

He was born in Peja, on 5 July 1934. He completed primary school in his birth place, secondary school in 1949, in Gjakova, and studies in biology in the Faculty of Natural Sciences in Belgrade, where he graduated in 1954.

In the academic year 1954/55 he worked as a professor of biology in the Teachers Training School in Prishtina. From 1955 to 1959 he completed his dissertation in the Physiological Institute of the Faculty of Natural Sciences in Belgrade, where he defended his doctoral dissertation on the topic **The Bio-energetic Aspect of Thermo- Adaptation of anura**.

From 1960 to his death, he lectured Comparative Physiology at the Department of Biology of the

të Prishtinës, së pari docent, mandej profesor inordinar dhe prej vitit 1974 profesor ordinar. Gjatë kësaj kohe ka qenë në specializime në Institutin Fiziologjik të Akademisë së Shkencave të BRSS në Leningrad (1962/63) dhe në Institutin Neurologjik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Kalifornisë në Los Anxhelos (1973/74).

Ka botuar në revistat shkencore të vendit dhe ato të jashtme disa punime shkencore nga fusha e adaptimit termik të shtazëve poikiloterme dhe të termoregulacionit dhe hipotermisë së shtazëve homeoterme dhe heteroterme. Me kontributet e veta ka marrë pjesë në punimet e disa tubimeve shkencore jashtë vendit.

Ka ushtruar funksionin e prodekanit (1960/62 dhe 1967/68) dhe të dekanit të Fakultetit Filozofik (1968/69). Ka qenë rektor i Universitetit të Prishtinës (1970/73) dhe kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë. Ishte delegat në Dhomën e Kombeve të Kuvendit të RSFJ-së dhe anëtar i redaksive të revistave *Dialektika* dhe *Acta physiologica Yugoslavica*.

Ishte nënkryetar dhe kryetar i ASHAK. Është laureat i Çmimit të Dhjetorit të Kosovës dhe i Shpërblimit 7 Korriku të RS të Serbisë për punë shkencore.

Vdiq në Prishtinë, më 23 gusht 1996.

Faculty of Philosophy/Natural Sciences in Prishtina, first as an Assistant Professor, then Associate Professor and from 1974 Full Professor. During that time, he was in specialization in the Physiological Institute of the Academy of Sciences in the USSR, in Leningrad (1962-1963) and in the Neurological Institute of the Medical Faculty of the University of California, Los Angeles (1973-1974).

He had works published in scientific reviews in the country and abroad, several works in the field of thermo-adaptation of poikilotherm animals and thermoregulation and hyperemia of homeotherm and hetero-thermo animals. With his contributions he took part at several scientific conferences abroad.

He was in the post of a vice-dean (1960-1962 and 1967-1968) and of the Dean of the Faculty of Philosophy (1968-1969). He was the Rector of the University of Prishtina (1970-1973) and President of the Yugoslav Association of Universities. He was a delegate to the Chamber of Nations of the SFRY Parliament and a member of the Editorial Board of the reviews *Dialektika (Dialectics)* and *Acta Physiologica Yugoslavica*.

He was a Vice-President of the Academy of Arts and Sciences of Kosova (AASK). He received the December Prize of Kosova and the Prize of 7 July of Serbia for his scientific contribution.

He died in Prishtina, on 23 August 1996.



Prof. dr. Idriz Ajeti
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1973/74 – 1974/75

Prof. Dr. Idriz Ajeti
Rector of the University of
Prishtina 1973–1975

Lindi në katundin Tupallë të Jabllanicës së Epërme, më 26.VI.1917. Shkollën fillore e mbaroi në Banjën e Sijarinës, më 1930, të mesmen e kreu në Shkup, më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofik të Universitetit të Zagrebit – në Degën e Romanistikës. Studimet i mbaroi pas luftës, në vitin 1949 në Fakultetin e Filozofik të Beogradit. Që atëherë e deri në vitin 1953, me cilësi profesori të gjuhës shqipe, punoi në Gjymnazin e Prishtinës. Nga viti 1953 deri në vitin 1960, me cilësi lektori, jepte mësim në Degën e Albanologjisë të Fakultetit të Filozofik të Beogradit. Në vitin 1958 mbrojti disertacionin e doktoratës me temën: “*Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zares së Dalmacisë*”. Që nga viti 1960, njëherë docent, pastaj profesor inordinar, dhe nga viti 1968, profesor ordinar, jep mësim në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filozofik të Prishtinës.

Fushat e interesimit shkencor të Idriz Ajertit janë dialektet nga pikëpamja diakronike, pastaj trajtimi i dokumenteve të moçme gjuhësore të shkruara me alfabetin arabo-turk dhe më në fund studimi i marrëdhënieve të shojsheqme shqiptare-serbe.

He was born in the village Tupalla of Upper Jablanica, on 26/06/1917. He finished primary school in Sijarinska Banja, in 1930, secondary school in Shkup (Skopje), in 1938. In the same year he registered his studies in the Faculty of Philosophy of the University of Zagreb – Department of Romanist Studies. He completed his studies after the World War II, in 1949, in the Faculty of Philosophy in Belgrade. From then to 1953, he worked at the Secondary School in Prishtina as a professor of the Albanian language. From 1953 to 1960, he taught Albanian as a language lecturer at the Department of Albanological Studies of the Faculty of Philosophy in Belgrade. In 1958 he defended his doctorate dissertation under the title: “*Historical Development of the Gheg Dialect of the Albanians of Zadar in Dalmatia*”. From 1960, he worked once as an Assistant Professor, then Associate Professor, and from 1968 as a Full Professor at the Department of Albanian Language and Literature of the Faculty of Philosophy in Prishtina.

Professor Ajeti’s field of scientific interests is the dialects seen from the diachronic aspect, then elaboration of old linguistic documents written in Arabic-Turkish alphabet, and finally he became interested in studying the Albanian-

Merret edhe me çështje të gjuhës së sotme shqipe. Qe iniciator i shumë konsultave dhe bashkë-marrëveshjeve gjuhësore ku u kërkuan shtigje të reja për njësimin e gjuhës shqipe dhe të drejtshkrimit të saj.

Hartoi tekste universitare dhe monografi shkencore.

Me iniciativën e tij, pas hapjes së Fakultetit të Prishtinës (1960), u nxor revista shkencore "*Gjurmime albanologjike*" (1962) e më 1974 u organizua Seminari i Kulturës Shqiptare për albanologë të huaj.

Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, më 1971-73 ishte dekan i Fakultetit Filozofik, në vitet 1973-75 rektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1979-1981 dhe 1996-1999 ishte kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Iu dhanë disa shpërblime e dekorata, ndër të cilat edhe Shpërblimi i 7 Korrikut i RS të Serbisë dhe ai i KAÇKJ.

Serbian mutual linguistic relationships. He also deals with present Albanian language issues. He was the initiator of numerous linguistic consultations and agreements in which new paths were sought for the unification of the Albanian language and its orthography.

He wrote university text-books and scientific monographs.

At his initiative, following the establishment of the Faculty of Philosophy in Prishtina (1960), the scientific review "*Gjurmime albanologjike*" (Albanologic Research) was published (1962), and in 1974 "The International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture" was organized for foreign albanologists.

During the period 1969-1971 he was Director of the Albanological Institute, in the period 1971-1973 Dean of the Faculty of Philosophy, in 1973-1975 Rector of the University of Prishtina. In the periods 1979-1981 and 1996-1999 he was President of the Academy of Sciences and Arts of Kosova.

He was awarded several prizes and decorations, among which the Prize 7 July of the Socialist Republic of Serbia and of AVNOJ.



Prof. dr. Feriz Krasniqi
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1975/76 – 1978/79

Prof. Dr. Feriz Krasniqi
Rector of the University of Prish-
tina 1975–1979

Lindi më 4.01.1931 në Tërpezë të Malishevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Gjimnazin e ulët e mbaroi në Prishtinë, kurse Shkollën Normale në Gjakovë. Në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Nishit studioi në degën e biologjisë, ku edhe diplomoi në vitin 1954. Një kohë punon arsimtar i biologjisë e pastaj regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Shkupit, në grupin e biologjisë, ku diplomoi në vitin 1961.

Më 1961 u zgjodh asistent për lëndën Sistematika e bimëve në Katedrën e Biologjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Disertacionin e doktoratës **Vegjetacioni i pyjeve të regjionit kodrinor të Kosovës** e mbrojti në vitin 1968 në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit.

Në vitin 1969 u zgjodh docent, kurse më 1980 profesor ordinar për lëndën Sistematika e bimëve të larta në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Prishtinës, ku punoi gjersa u pensionua. Puna kërkimore-shkencore e tij është e orientuar kryesisht në studimin e florës dhe të vegjetacionit.

He was born on 04/01/1931 in the village Terpeza of Malisheva. He finished primary school in his birthplace, secondary school in Prishtina, and Teachers Training School in Gjakova. He studied at the Department of Biology of the Higher Pedagogical School in Nish, where he graduated in 1954. Some time he worked as a teacher of biology and then he registered his studies in the Faculty of Mathematical-Natural Sciences of the University of Skopje, in the Group of Biology, where he graduated in 1961.

In 1961 he was elected assistant of the subject Plant Systematization at the Department of Biology of the Faculty of Philosophy in Prishtina. He defended his doctorate dissertation under the title **Vegetation of Forestry in Mountainous Regions of Kosova** in 1968, at the Faculty of Mathematical-Natural Sciences of the University of Belgrade.

In 1969, he was elected Assistant Professor, and in 1980 Full Professor for the subject Higher Plant Systematization in the Faculty of Mathematical-Natural Sciences in Prishtina, where he worked until he was retired. His scientific research work is directed mainly to the studies of flora and vegetation.

Për kontributin e tij në lëmin e kërkimeve shkencore u nderua me këto shpërblime dhe mirënjohje: Shpërblimi Krahinor i Dhjetorit për rezultatet e arritura në shkencat biologjike gjatë vitit 1975; Plaketa nga Fakulteti i Mjekësisë dhe shpërblimi **Naim Frashëri** për tekstin universitar *Sistematika e bimëve të larta me elementet e filogjenisë*, të botuar në vitin 1985.

Në vitin 1995, Senati i Universitetit të Prishtinës ia jep titullin *Profesor emeritus* për merita të veçanta në zhvillimin dhe të avancimin e Universitetit të Prishtinës, si dhe për përsosmërinë mësimore dhe shkencore.

Në vitin 2000 zgjidhet anëtar i rregullt i Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

He was awarded the following prizes and recognitions for his contribution to scientific field: the Provincial Prize of December for his results reached in the field of biological sciences in 1975; A Decoration from the Medical Faculty of Pristine and the Prize **Naim Frashëri** for his university text-book titled *Higher Plants Systematization with Elements of Philogena*, published in 1985.

In 1995, the Senate of the University of Prishtina awarded him the title *Professor Emeritus* for his specific merits in the development and advancement of the University of Prishtina, and for his teaching and scientific results.

In 2000, he was elected full member of the Academy of Sciences and Arts of Kosova.



Prof. dr. Gazmend Zajmi
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1979/80 -1980/81

Prof. Dr. Gazmend Zajmi
Rector of the University of Prish-
tina 1979-1981

Lindi më 20. VI. 1936 në Krumë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin Juridik e mbaroi në Beograd. Mbrojtji disertacionin e doktoratës më 1972 në Fakultetin e Shkencave Politike të Beogradit me tezën: *Mbrojtja dhe trajtimi kushtetues-juridik i gjuhëve të pakicave kombëtare në Evropë në mes të dy luftërave botërore.*

Më 1961, u zgjodh asistent i Fakultetit Juridik në Prishtinë për lëndën E drejta kushtetuese. Që prej kësaj kohe punoi vazhdimisht me cilësi pedagogu në Fakultetin Juridik, dhe një kohë ishte prorektor dhe rektor i Universitetit të Kosovës në Prishtinë. Ligjëroi lëndët Sistemi politik dhe E drejta kushtetuese në Shkallën III të po këtij Fakulteti. Ishte kryetar i Shoqatës Krahinore të Politikologëve, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shoqatave të Shkencave Politike të Jugosllavisë, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Shoqatës të së Drejtës Komparative të Jugosllavisë, anëtar i Pleqësisë Federative Juridike, kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë, anëtar i Komitetit të Përhershëm të Konferencës së Rektorëve të Evropës etj. Ishte në detyrën e këshilltarit shkencor në Institutin për Kërkime Juridike të Fakultetit Juridik të Prishtinës.

He was born on 20/06/1936 in Kruma. He finished primary and secondary school in Prizren, and graduated from Law in the Faculty of Law in Belgrade. He defended his doctorate dissertation in 1972 at the Faculty of Political Sciences in Belgrade under the title: *Constitutional and Legal Protection and Treatment of National Minority Languages in Europe between the Two World Wars.*

In 1961, he was elected Assistant of the Faculty of Law in Prishtina for the subject the Constitution Law. Since that time he worked continually as a teacher in the Faculty of Law, and for some time he was Rector of the University of Kosova in Prishtina. He taught the subjects Political System and Constitutional Law to postgraduate students of this Faculty. He was President of the Provincional Association of Politicologists, member of the Presidency of the League of Scientific Political Association of Yugoslavia, member of the Executive Council of the Association of Comparative Law of Yugoslavia, member of the Federal Lawyers Council, President of the Yugoslav Universities Union, member of the Permanent Conference of European Rectors, etc. He was on the duty of scientific adviser to the Institute for Legal Research Work of the Faculty of Law in Prishtina.

Ka shumë punime shkencore, nga të cilat katër me karakter monografik. Është bashkautor i librit universitar të Universitetit të Beogradit Sistemi shoqëroro-politik i Jugosllavisë. Në këto punime kryesisht trajtohet problematika e pakicave kombëtare, e aspekteve socio-politike të pozitës së gjuhëve dhe e autonomisë dhe e federalizmit. Krahas kësaj, është autor i tre librave komponimesh dhe i dy librave vargjesh në fushën e krijimitarisë muzikore dhe të poezisë. Ishte anëtar i Redaksisë së **Enciklopedisë Politike** në Beograd.

Për rezultatet e tij në lëmin shkencor, pedagogjik dhe shoqëror – politik u dekorua me Urdhrin e Punës me Kurorë të Artë dhe me Urdhrin e Vëllazërim-Bashkimit me Kurorë të Artë.

Ka qenë anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kryetar i saj.

Vdiq më 10 mars të vitit 1995 në Zagreb.

He has many scientific works, of which four are of monograph types. He was co-author of the University Book of the University of Belgrade – The Social-Political System of Yugoslavia. These works treat generally the problems of national minorities, and social-political aspects of the position of their languages and of autonomy and federation. Parallel to this, he was the author of three books of musical composition and two books of poetry in the field of musical and poetry creations. He was a member of the Editorial of **Political Encyclopedia** in Belgrade.

For his results in the scientific, pedagogical and social-political fields he was decorated with a Work Order with Golden Crown and Brotherhood-Fraternity Order with a Golden Crown.

He was a regular member of the Academy of Sciences and Arts of Kosova and its President.

He died in Zagreb on 10 March 1995.



Prof. dr. Minir Dushi
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1981/82 – 1982/83

Prof. Dr. Minir Dushi
Rector of the University of Prish-
tina 1981–1983

Lindi në vitin 1929 në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme teknike e mbaroi në Nish (1950). Studioi Fakultetin e Xehetarisë në Beograd, ku diplomoi në vitin 1958. Doktoroi, po ashtu, në Universitetin e Beogradit në vitin 1965. Në vitin 1969 u zgjedh profesor inordinar i Fakultetit Teknik të Prishtinës. Me themelimin e Universitetit të Prishtinës (1970) u zgjedh prorektor. Në qershor të vitit 1975 u zgjedh profesor ordinar i FXM në Mitrovicë. Ishte dekan në FXM në Mitrovicë, të cilin e ka ushtruar dy mandate.

Ka shumë njësi bibliografike: studime, projekte, elaborate, recensionë, tekste universitare, botime të veçanta etj. Ka të botuara 5 tekste universitare dhe 4 botime të veçanta.

Për kontributin e tij në lëmin e kërkimeve shkencore u nderua me shpërblime e mirënjohje: **Shpërblimin Krahinor të Dhjetorit, Shpërblimin "Nikolla Tesla" dhe atë të "7 Korrikut" të RS të Serbisë.**

Me rastin e shënimit të 25-vjetorit të themelimit të Universitetit iu dha titulli **profesor emeritus.**

He was born in 1929 in Gjakova, where he finished primary school, and secondary engineering school in Nish (1950). He studied in the Faculty of Mining in Belgrade, where he graduated in 1958. He also defended his doctorate dissertation in the University of Belgrade in 1965. In 1969 he was elected Associate Professor in the Faculty of Engineering in Prishtina. When the University of Prishtina was founded (1970), he was elected Vice-Rector. In June 1975 he was elected Full Professor of the Faculty of Mining and Metallurgy (FMM) in Mitrovica. He was Dean of the FMM in Mitrovica, and performed the duty in two mandates.

He has many bibliographic units: studies, projects, elaborations, reviews, university text-books, special publications, etc. He has 5 university text-books published and 4 special publications.

He was honored with the following prizes and recognitions for his contribution made to scientific researches: **Provincial December Prize, the prizes "Nikola Tesla" and "7 July" of the SR of Serbia.**

On the occasion of 25th anniversary of the establishment of the University he was awarded the title of **Professor Emeritus.**

Është bartës i shumë dekoratave nga lufta dhe të pranimeve shoqërore. Si redaktor përgjegjës i revistës “Kërkime”, të cilën qysh nga viti 1980 e boton Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe si kryeredaktor i revistës së dikurshme "**Plumbzinku**", të cilën e ka botuar (1968) Instituti për Plumb dhe Zink, ka kontribuar jo vetëm në daljen e rregullt të këtyre revistave, por edhe në përmbajtjen e tyre.

Është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

He is the carrier of many decorations of war and social recognitions. As the Responsible Editor of the review “Kërkime” (Research), which has been published by the Academy of Sciences and Arts of Kosova since 1980 and Editor-in-Chief of the former review "**Plumbzinku**" (**Lead-Zink**), which was published by the Institute of Lead and Zink (1968), he contributed not only on regular publication of these two reviews, but also to their contents.

He is a full-time member of the Academy of Sciences and Arts of Kosova.



Prof. dr. Hajredin Hoxha
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1983/84 – 1984/85

Prof. Dr. Hajredin Hoxha
Rector of the University of Prish-
tina 1983–1985

Lindi në Shtimje, më 5.5.1926, ku e mbaroi edhe shkollën fillore. Pas kryerjes së Fakultetit Filozofik, Hajredin Hoxha prej vitit 1968 në mënyrë intensive merret me punë pedagogjike dhe shkencore. Në vitin 1959 zgjedhet profesor dhe drejtor i Shkollës së Lartë Administrative të Prishtinës. Ishte mësimdhënës në Fakultetin Filozofik dhe më vonë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Magjistroi në Fakultetin e Shkencave Politike të Beogradit. Në vitin 1972 u doktorua në Fakultetin Filozofik të Lubjanës me tezën me titull: “Procesi i afirmimit nacional të kombësisë shqiptare në Jugosllavi “. U zgjodh profesor ordinar i lëndës së sociologjisë. Ishte shef i Katedrës së Sociologjisë dhe ligjërues i sociologjisë në Fakultetin Juridik. Ishte dekan i Fakultetit Juridik në Prishtinë.

Përveç detyrave të ndryshme në organet e Universitetit dhe të Krahinës, ishte edhe kryetar i Kuvendit të BVI-së Krahinore të Punës Shkencore dhe kryetar i Këshillit të BVI të Punës Shkencore të Jugosllavisë. Ishte edhe kryetar i Shoqatës së Sociologëve, të Filozofëve dhe të Politologëve të Kosovës dhe nënkryetar i Lidhjes së Sociologëve të Jugosllavisë.

He was born on 5/05/1926, where he finished primary school. After his graduation at the Faculty of Philosophy, from 1968 he dealt with pedagogical and scientific work in an intensive manner. In 1959 he was elected professor and Director of the Higher Administrative School in Prishtina. He was a professor in the Faculty of Philosophy and later of the Faculty of Law of the University of Prishtina. He defended his master thesis at the Faculty of Political Sciences in Belgrade. In 1972 he defended his doctorate dissertation at the Faculty of Philosophy in Ljubljana titled: “The Process of National Affirmation of Albanian Nationality in Yugoslavia”. He was elected Full Professor of the subject of Sociology. He was head of the Department of Sociology and Philosophy and lectured Sociology in the Faculty of Law. He was Dean of the Faculty of Law in Prishtina.

Apart from different duties in the bodies of the University and Province, he was also President of the Assembly of the Provincial Associated Self-managing Interest of Scientific Work and President of the Yugoslav Council of Associated Self-managing Interest of Scientific Work. He was also President of the Association of Sociologists, Philosophers and Politicologists of

Ka publikuar shumë punime shkencore dhe ka marrë pjesë me referate në disa kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare për çështjen nacionale.

Ishte anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Vdiq më 11 gusht 1987.

Kosova and Vice-President of the League of Sociologists of Yugoslavia.

He published many scientific works and presented papers at several international congresses and symposiums on national issues.

He was a part-time member of the Academy of Sciences and Arts of Kosova.

He died on 11 August 1987.



Prof. dr. Skënder Karahoda
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1989/90 – 1990/91

Prof. Dr. Skënder Karahoda
Rector of the University of Prish-
tina 1989–1991

Lindi në Prizren, më 1941. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd më 1969. Specializimin dhe studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë-Stomatologjisë në Beograd. U doktorua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, në prill të vitit 1980, me temën: “STUDIME KOMPARATIVE TË VLERËS SË REZULTATEVE KLINIKE DHE LABORATORIKE TE PACIENTËT ME PROTEZË TOTALE”.

Më 1977 zgjedhet asistent i Protetikës stomatologjike në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku arrin gradën prof. inordinar në Degën e Stomatologjisë. Ka punime nga lëmi i stomatologjisë.

He was born in Prizren in 1941. He finished primary and secondary school in his birthday, and completed the Faculty of Dentistry in Belgrade in 1969. He completed specialization and post-graduate studies at the Faculty of Medicine-Dentistry in Belgrade. He defended his doctorate dissertation at the Medical Faculty in Prishtina, in April 1980, under the title: “*Comparative Studies of Clinical and Laboratory Results Value to Patients of Total Prosthesis*”.

In 1977, he was elected assistant for the subject Prosthetic Dentistry in the Medical Faculty of Prishtina, where he obtained the title of Associate Professor at the Department of Dentistry. He has works published in the field of dentistry.



Prof. dr. Ejup Statovci
Rektor i Universitetit të
Prishtinës 1991/92 – 1997/98

Prof. Dr. Ejup Statovci
Rector of the University of Prish-
tina 1991–1998

Lindi më 16 prill 1940, në fshatin Prugovc, Komuna e Prishtinës. Shkollën fillore e ka kryer në Besijë, kurse normalen në Prishtinë, më 1960. Fakultetin Juridik e ka kryer në Zagreb, më 1966. Në vitin 1967 është zgjedhur asistent i Fakultetit Juridik për lëndët civile. Ka magjistruar në Fakultetin Juridik të Zagrebit, më 1971. Atë vit është zgjedhur docent. Doktoroi në Fakultetin Juridik të Lubjanës, më 1974 me temën “Marrëdhëniet pronësore juridike në patundshmëritë në KSA të Kosovës”. Në vitin 1975 është zgjedhur profesor inordinar për lëndët E drejta civile dhe E drejta sendore. Më 1980 është zgjedhur profesor ordinar.

